

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XVIII, nr. 5649  
E hënë, 10 dhjetor 2018  
çmimi 0.40 €

## Bizneset kërkojnë rinegociim të pozitës së Kosovës në CEFTA



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)



facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

**AWR** **ABBRUCH** GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

FLET PËR "EPOKËN E RE", DUKAGJIN GORANI | FAQE 4-5

## Projektrezoluta e PSD-së për dialog nuk negociohet

Këtu ka vetëm dy zgjidhje: ose ta hedhin poshtë në tërësi përpjekjen e PSD-së ose ta pranojnë në tërësi



Nënkryetari i Partisë Socialdemokrate, Dukagjin Gorani, ka bërë me dije se projektrezoluta dhe projektligji për dialogun me Serbinë i këtij subjekti politik nuk mund të negociohen. Në këtë intervistë dhënë për gazetën

"Epoka e re", ai ka thënë se Kuvendi i Kosovës ose duhet ta hedhë poshtë në tërësi përpjekjen e PSD-së ose ta pranojë në tërësi. Ai ka treguar se këto dy dokumente janë të ndërlidhura njëri me tjetrin. Sipas Dukagjin

Goranit, rezoluta pa ligj nuk ka fuqi detyruese, kurse ligji pa rezolutë nuk ka kuptim politik. Deputeti i PSD-së ka thënë se dokumentet e kësaj partie e formësojnë institucionin negociator të Kosovës për procesin e dialogut

TË DIELËN U BË NJË VIT NGA VDEKJA E ARTISTIT BLERIM PECI

## Artisti Blerim Peci do të kujtohet përgjithmonë

Të dielën është mbajtur akademi përkujtimore me rastin e njëvjetorit të vdekjes së artistit Blerim Peci. Të pranishëm në këtë akademi përkujtimore ishin përfaqësues të institucioneve të Republikës së Kosovës, deputetë, aktorë, familjarë të artistit Blerim Peci dhe përfaqësues të tjerë. Në fund të kësaj akademie është shfaqur dokumentari "Përgjithmonë" kushtuar artistit Blerim Peci



## Kosova vazhdon të përballet me shkallë të lartë të korrupsionit

MBI 75 PËR QIND E BIZNESEVE BESOJNË SE KORRUPSIONI NË KOSOVË ËSHTË SISTEMOR F. 8

## KULTURË

FLORI RRËMBEN ÇMIMIN E PARË NË 'KËNGA MAGJIKE' F. 13

## SPORT

PRISHTINA DHE FERONIKELI, PA PROBLEM NË ÇEREKFINALE, ELIMINOHET BESA F. 20



**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhepcisht-Tetovë  
Curëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
www.kolegijbiznesi.com  
info@kolegijbiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**DINO**  
Konjuh Lipjan, Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë  
tel & fax +381 38 566 666

## Këshilli i BE-së diskuton taksën dhe mandatin e FSK-së

BRUKSEL, 9 DHJETOR - Në Bruksel sot (e hënë) pritet të mbledhet Këshilli i Ministrave të Jashtëm të Bashkimit Evropian (BE) ku do të diskutojë për situatën në Ballkanin Perëndimor dhe sfidat me të cilat ballafaqohen vendet e rajonit. Këshilli i BE-së pritet ta përsërisë pikëpamjen e tij se Kosova duhet t'i tërheqë tarifën për mallrat që hyjnë nga Serbia dhe Bosnjë e Hercegovina, raportojnë mediet serbe. Po

ashtu, ky Këshill do të diskutojë edhe për ndryshimin e mandatit të FSK-së, i cili, sipas tyre, duhet të ndryshohet vetëm në bazë të Kushtetutës.

Në takimin e fundit për këtë vit, ministrat e BE-së do të flasin për situatën në Ballkanin Perëndimor dhe procesin e zgjerimit të BE-së. Edhe pse nuk është zyrtare, njoftohet se ministrat do të fokusohen në gjendjen e Bosnjë e Hercegovinës

pas zgjedhjeve, zbatimin e marrëveshjes së Shkupit dhe Athinës për emrin si dhe për zhvillimet në dialogun Beograd - Prishtinë. Në Këshillin e BE-së, presidenti serb, Aleksandar Vučić dhe presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, janë të angazhuar në një punë 'jashtëzakonisht të vështirë' për të gjetur një zgjidhje gjithëpërfshirëse. BE-ja thotë se dialogu kërkon leadership dhe unitet nga të dyja palët.



## Studentët duan përmbushje të kërkesave, jo negociim të tyre

Edhe pse institucionet më të larta shtetërore, Kryeministria dhe Ministria e Arsimit, u kanë bërë thirrje studentëve të ulen në tavolinë me ta që t'i shqyrtojnë këto kërkesa, studentët kanë refuzuar dialogun me ta, duke thënë se duan përmbushje të kërkesave, jo negociim të tyre

TIRANË, 9 DHJETOR - Studentët e Universitetit të Tiranës kanë protestuar edhe të dielën, për të pestën ditë me radhë, me kërkesat për ulje të tarifave të shkollimit dhe përmirësim të cilësisë në arsimin publik të Shqipërisë.

Institucionet më të larta shtetërore, Kryeministria dhe Ministria e Arsimit, u kanë bërë thirrje studentëve të ulen në tavolinë me ta që t'i shqyrtojnë këto kërkesa. Megjithatë, studentët kanë refuzuar dialogun me ta, duke thënë se duan përmbushje të kërkesash, jo negociim të tyre.

Mediat turke njoftuan të shtunën se kryeministri Edi

Rama ka fluturuar drejt Turqisë dhe është takuar me presidentin Rexhep Tajip Erdogan, në një kohë kur Tirana "vlon" nga protesta e studentëve, që ka hyrë në ditën e pestë para godinës së Ministrisë së Arsimit.

Por të dielën në "Facebook", kryeministri ka postuar një video nga banesa e Age Palit në Ishull Lezhë, ku tri vajzave të familjes u premtoi ndërtimin e shtëpisë dhe lidhur me largimin e kryeministrit kanë reaguar edhe nga Partia Demokratike.

Deputeti demokrat Tritan Shehu pyet nëse "mundet që kryeministri të mjeçullojë me



një foto të sotme nga Lezha lajmin e së shtunës për largimin e tij nga vendi, dhe ai i shoqëruar po me foto!" Sipas Shehut, kryeministri "duhet të sqarojë se ku ndodhej në këto ditë protestash mbarëpopullore në vend, veçanërisht pas atij lajmi pothuajse zyrtar".

Përpos kërkesës për përgjysmim të tarifës së studimit dhe përmirësimit të cilësisë, në

kërkesat e studentëve përfshihen edhe përmirësimi i kushteve të konvikteve, rritja e buxhetit për arsimin me 8 % të GDP-së në buxhetin për vitin 2019, pajisja e të gjithë studentëve me kartën e studentit dhe disa pika të tjera që kanë të bëjnë me përfaqësimin e tyre në borde administrative dhe mbështetje financiare të aktiviteteve dhe kërkimeve të

tyre shkencore.

Qeveria e Shqipërisë thotë se tarifën nuk i përcakton ministria, por ato caktojnë universitetet. Megjithatë, protestuesit pohojnë të kundërtën, duke thënë se është Qeveria ajo që ka caktuar çmimet tavan. Tarifën vjetore për studentët në universitetet shtetërore të Shqipërisë variojnë nga 25 mijë lekë (rreth 200 euro) deri në 40 mijë lekë (rreth 325 euro) në ciklin e parë të studimeve (bachelor). Ndërsa, për ciklin e dytë të studimeve, sipas profilit që ndjekin, tarifën variojnë nga 63 mijë (rreth 510 euro) deri në 204 mijë lekë (rreth 1 600 euro). Këto tarifa konsiderohen të jenë ndër më të lartat në Evropë për universitetet publike, në kohën kur shumë shtete si Gjermania dhe vendet e Skandinavisë kanë hequr tërësisht pagesat për shkollimin publik. Shqipëria vazhdon të jetë ndër shtetet më të varfra në Evropë.

## Ahmeti, i shqetësuar për ndryshimet kushtetuese

SHKUP, 9 DHJETOR - Kryetari i BDI-së, Ali Ahmeti, është i shqetësuar për procesin e ndryshimeve kushtetuese. Në intervistën javore për "Radion Evropa e Lirë", Ahmeti ka deklaruar se zhvillimet e fundit e vënë në rrezik procesin i cili, sipas tij, mund të dëmtohet lehtë. Mes rreshtave, Ahmeti pretendon se arrestimet e fundit, përfshirë edhe atë të ish-shefit të DSK-së, Sasho Mijallkov, cenojnë shumicën

prej 2/3. "Sikur kam një shqetësim. Ky është një proces shumë i rëndësishëm. Frikësohem të mos lëndohet nga pakujdesitë e institucioneve. Të mos krijohet përshtypja se procesi është mbyllur dhe ka përfunduar. Ky proces ende është në zhvillim dhe duhet të gjitha institucionet shtetërore, ligjvënëse, ligjzbatuese të jenë të kujdesshme dhe ta ruajnë nga ndonjë inflamacion i jashtëm sepse lehtësisht mund të dëm-



tohet imuniteti i këtij procesi", tha Ali Ahmeti.

I pyetur për ish-partnerin e tij të koalicionit, ish-kryeministrin Nikolla Gruevski dhe arratisjen

e tij, Ahmeti vlerëson se Gruevski duhet të ketë pasur arsye të forta që të largohet. Megjithatë, i pari i BDI-së nuk ka besuar se ish-partneri i tij qeverisës do të arratiset. "Nuk dua të spekuloj, por nuk kam menduar se ai do të largohet nga shteti, mirëpo ai duhet t'i di arsyet më të forta përse është larguar. Për të marrë një vendim të tillë nuk është e lehtë. Pres që ai të bëjë më shumë shpjegime për opinionin", tha Ali Ahmeti.

Ndryshimet kadrovike dhe reformatimi i kabinetit qeveritar deri më tani nuk ka qenë pjesë e diskutimeve brendapartiake dhe mes partnerëve të koalicionit. Ahmeti vlerëson se proceset në vijim janë më të rëndësishme sesa reformatimi i Qeverisë. Sa i përket presidentit konsensual, Ahmeti shton se mes partnerëve të koalicionit ekziston ideja, por me kreun e Qeverisë, Zoran Zaev, ende nuk është biseduar për detaje.

## Kryetari i Kuvendit të Shqipërisë sot viziton Maqedoninë

TIRANË, 9 DHJETOR - Kryetari i Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, Gramoz Ruçi, sot (e hënë) do të bëjë një vizitë

zyrtare në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë. Përveç takimit me homologun e tij Talat Xhaferi, Ruçi do

të takohet edhe me grupin parlamentar të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë për bashkëpunim me

Kuvendin e Republikës së Shqipërisë pas të cilit takim pritet të ketë deklaratë për media.



Me aktivitete të ndryshme është shënuar të dielën Dita Ndërkombëtare Kundër Korrupsionit

# Kosova vazhdon të përballet me shkallë të lartë të korrupsionit

Pavarësisht prej angazhimeve të institucioneve për zbatimin e ligjit, Kosova përballet me nivelin e lartë të korrupsionit. Kështu është thënë të dielën me rastin e shënimit të 9 dhjetorit, Ditës Ndërkombëtare Kundër Korrupsionit. Ambasadori amerikan në Prishtinë, Philip Kosnett, ka thënë se ka ardhur koha që premtimi për llogaridhënie të bëhet realitet dhe të korruptuarit ta kenë vendin në burg. Edhe ambasadori i Britanisë së Madhe në Kosovë, Ruairi O'Connell, ka thënë se Kosova ka problem me politikanët dhe zyrtarët e korruptuar, të cilët, sipas tij, më tepër punojnë për interesat e tyre personale sesa për interesin e shoqërisë

**EPOKA E RE** Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 9 DHJETOR - Me aktivitete të ndryshme në Kosovë është shënuar të dielën Dita Ndërkombëtare Kundër Korrupsionit. Ambasadori amerikan në Prishtinë, Philip Kosnett, ka kërkuar nga qytetarët e Kosovës të bëjnë veprime konkrete për t'i luftuar politikanët e korruptuar. Ai në një video të publikuar në "Facebook" ka thënë se përkushtimi i qytetarëve të Kosovës kundër korrupsionit është themeli i arritjes së synimit për integrim perëndimor. "Sapo kam ardhur në Kosovë për të shërbyer si ambasador i ShBA-së dhe dëshiroj t'jua bëj me dije se Qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës është e përkushtuar ndaj suksesit të shtetit të Kosovës. Besoj se përkushtimi i qeverisë dhe popullit të Kosovës për ta luftuar korrupsionin në çdo nivel është themeli i arritjes së begatisë dhe integritetit perëndimor që e synoni. Ligjet e mira dhe procesi më transparent janë të rëndësishme, por nuk mjafton t'i kenë sistemet në letër nëse ato nuk zbatohen me ndershmëri, plotësisht dhe në mënyrë të vijueshme", ka deklaruar ai. Diplomati amerikan ka thënë se ka ardhur koha që premtimi për llogaridhënie të bëhet realitet. "Qytetarët e Kosovës duhet ta shohin se ligji po zbatohet në mënyrë të barabartë për të gjithë dhe që ai të përdoret për ta ndëshkuar sjelljen korruptuese, veçanërisht kur kryesit janë zyrtarë qeveritarë dhe bashkëpunëtorët e tyre më të afërt. Ju nxis të shikoni përtej interesave personale dhe ta kërkonit me ngulm drejtësinë dhe llogaridhënien që

qytetarët e dëshirojnë dhe e meritojnë. Llogaridhënie do të thotë shkelësit e ligjit në burg, konfiskim të pasurisë së fituar në mënyrë të paligjshme, si dhe afate konkrete kohore për ndryshim. Ka ardhur koha që premtimi për llogaridhënie të bëhet realitet", është shprehur Kosnett. Edhe ambasadori i Britanisë së Madhe në Kosovë, Ruairi O'Connell, ka thënë se Kosova ka problem me politikanët dhe zyrtarët e korruptuar, të cilët më tepër punojnë për interesat personale sesa për interesin e shoqërisë. Ai nëpërmjet një videoje të publikuar në llogarinë zyrtare të Ambasadës së Britanisë së Madhe në Prishtinë në "Facebook" ka thënë se shteti britanik po bashkëpunon edhe me sistemin e drejtësisë dhe shoqërinë civile, në mënyrë që ta monitorojnë sa më mirë punën e gjykatave për ta çrrënjësuar korrupsionin. "Për këto arsye, ne në Ambasadën Britanike në Kosovë punojmë që t'i mbështesim njerëzit e guximshëm, siç është rasti i Murat Mehmetit, një zyrtar i Administratës Tatimore, i cili punon për ta luftuar korrupsionin", ka thënë O'Connell. Ndërsa drejtori i Agjencisë Kundër Korrupsionit (AKK), Shaip Havolli, ka vlerësuar se korrupsioni në Kosovë është në nivel të lartë. Megjithatë, ai ka thënë se së bashku me institucionet e tjera janë të mobilizuar që sa më shumë ta luftojnë këtë dukuri. "Fotografitë këtu shumë mirë e pasqyrojnë nivelin e korrupsionit në vendin tonë. Niveli i korrupsionit në vend është i lartë edhe përkundër angazhimeve të institucioneve për zbatim të ligjit në këtë rast dhe të Agjencisë Kundër



Korrupsionit. Jemi të mobilizuar që sa më shumë ta luftojmë bashkërisht edhe me institucione të tjera. Shoqëria civile në këtë rast është shumë aktive. Nga shoqëria civile, në këtë rast KDI-ja, kemi marrë shumë informacione gjatë këtij viti sa iu përket disa situatave që kanë të bëjnë me çështje të konflikt të interesit, çështje në prokurim publik dhe fusha të tjera", ka deklaruar Hovolli në ceremoninë e ndarjes së çmimeve për tri vendet e para në garën e fotografive dhe videove me rastin e shënimit të 9 Dhjetorit, Ditës Ndërkombëtare Kundër Korrupsionit të organizuar nga Instituti Demokratik i Kosovës (KDI). Në këtë ceremoni ka marrë pjesë

edhe sekretarja e parë në Ambasadën e Gjermanisë në Kosovë, Anja Becky. Ajo ka bërë thirrje për luftimin e korrupsionit në Kosovë, duke thënë se kjo dukuri dëmton zhvillimin e vendit. "Korrupsioni nuk është diçka abstrakte, por diçka që dëmton jetën tonë të përditshme dhe zhvillimin tonë. Na gëzon fakti që qytetarët kanë marrë pjesë në numër kaq të madh në këtë garë, kanë sjellë idetë e tyre dhe na kanë treguar për pasojat që korrupsioni i shkakton", ka theksuar Becky. Kurse zyrtari ligjor i KDI-së, Florent Spahija, ka treguar se pjesë e pandashme e punës së këtij instituti është dhënia e këshillave ligjore pa pagesë për qytetarët që duan ta raportojnë korrupsionin,



## Kurti: Qytetarët mbetën të izoluar për shkak të pushtetit të korruptuar

Lideri i Lëvizjes Vetëvendosje (LV), Albin Kurti, ka thënë se viti 2018 ka qenë dështim i Kosovës në rrugëtimin drejt Bashkimit Evropian. Ai ka thënë se qytetarët e Kosovës kanë mbetur të izoluar për shkak të pushtetit të korruptuar. "Vendi ynë asnjëherë më parë nuk ka qenë më larg BE-së. Qytetarët mbetën të izoluar nga pushteti i korruptuar. Ne kemi rrugëtuar bashkë me partnerët dhe miqtë tanë të Bashkimit Evropian dhe ShBA-së dhe u bëjmë thirrje që të mos i izolojnë qytetarët, por pushtetin e pamertuar dhe të korruptuar", ka deklaruar Kurti në një konferencë për medie. Edhe Avni Zogiani nga kjo lëvizje ka vlerësuar se Kosova aktualisht gjendet në krizë të thellë dhe, sipas tij, zgjidhja e vetme është shpallja e zgjedhjeve kombëtare.

sinjalizuesit e korrupsionit dhe dëshmitarët e korrupsionit. "Të drejtat e punëtorëve, integriteti në sistemin e drejtësisë, financimi i subjekteve politike dhe prokurimi publik janë fushat që KDI-ja është angazhuar vazhdimisht. I bëjmë thirrje Qeverisë së Kosovës t'i shkarkoj ministrat dhe zëvendësministrat me aktakuza. Po ashtu, rikthejmë vëmendjen duke kërkuar sërish dorëheqjen e kryeprokurorit të shtetit, z. Lumezi. I bëjmë thirrje prokurorisë dhe policisë që të bashkohen në luftë kundër korrupsionit, njëkohësisht gjykatat të japin dënime më të ashpra për të korruptuarit", ka thënë Spahija. Po në Ditën Botërore Kundër Korrupsionit, në Sheshin "Skënderbeu" në Prishtinë është vendosur një rosë e verdhë prej gome, si simbol botëror për luftën kundër korrupsionit.

## Rinis kursi i italishtes si lëndë e obligueshme në Fakultetin e Filologjisë



PRISHTINË, 9 DHJETOR (ER) - Në Fakultetin e Filologjisë, të hënën, më 12 dhjetor, rinis kursi i italishtes si lëndë e obligueshme për ata që duan ta mësojnë italishten si gjuhë të dytë në vitin e parë të studimeve, ndërkaq do të mund të marrin pjesë edhe studentët që duan ta mësojnë italishten si lëndë zgjedhore (fillimisht vetëm brenda departamenteve të

Filologjisë).

Dekanja e Fakultetit të Filologjisë, Lindita Rugova, ka bërë me dije për gazetën "Epoka e re" se rinisja e mësimin të italishtes nënkupton edhe rifillimin e punës së Institutit të Gjuhës dhe të Kulturës Italiane në kuadër të UP-së, i themeluar disa vjet më parë në bashkëpunim me Ambasadën Italiane në Kosovë. Ajo ka

treguar se instituti do ta bashkërendisë veprimtarinë e tij së bashku me Drejtorinë e Institutit të Kulturës Italiane në Tiranë dhe me Ambasadën e Republikës së Italisë në Prishtinë.

Dekanja Lindita Rugova ka theksuar se Fakulteti i Filologjisë dhe UP-ja në përgjithësi në dy vjetet e fundit kanë nënshkruar marrëveshje

bashkëpunimi me disa universitete italiane që përgatisin kuadro të italishtes për të huajt (Venecia, Peruggia, Napoli, Kalabria) dhe synojnë që të ngrihen niveli i mësimin dhe i studimit të italishtes në Kosovë, por edhe i gjuhëve të tjera të grupit të romanistikës në përgjithësi, e që nuk ofrohen për nivelin universitar (siç është spanjishtja dhe portugalishtja).

Flet për "Epokën e re", Dukagjin Gorani

# Projektrezoluta e PSD-së për dialog n

Këtu ka vetëm dy zgjidhje: ose ta hedhin poshtë në tërësi përpjekjen e PSD-së ose ta pranojnë në tërësi



Nënkryetari i Partisë Socialdemokrate, Dukagjin Gorani, ka bërë me dije se projektrezoluta dhe projektligji për dialogun me Serbinë i këtij subjekti politik nuk mund të negociohen. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se Kuvendi i Kosovës ose duhet ta hedhë poshtë në tërësi përpjekjen e PSD-së ose ta pranojë në tërësi. Ai ka treguar se këto dy dokumente janë të ndërlidhura njëri me tjetrin. Sipas Dukagjin Goranit, rezoluta pa ligj nuk ka fuqi detyruese, kurse ligji pa rezolutë nuk ka kuptim politik. Deputeti i PSD-së ka thënë se dokumentet e kësaj partie e formësojnë institucionin negociator të Kosovës për procesin e dialogut

e PSD-së e formësojnë institucionin negociator të Kosovës për procesin e dialogut. "Me të qartësohen mandati, përfaqësimi, vendimmarrja dhe llogaridhënia në delegacionin shtetëror. Po ashtu, fuqizimi i saj realizohet përmes Projektligjit për Dialogun i cili duhet të votohet në Kuvend. Këto dy dokumente janë të ndërlidhura njëri me tjetrin. Rezoluta pa ligj nuk ka fuqi detyruese, kurse ligji pa rezolutë nuk ka kuptim politik", është shprehur ai, duke shtuar PSD-ja dhe grupi i saj parlamentar e kuptojnë dialogun me Republikën e Serbisë si proces të paevitueshëm, edhe pse i padrejtë politikisht dhe historikisht. "Tash e një vit ajo që pamë nga pushteti vendor ishte amatorizëm politik dhe paaftësi qeverisëse karshi një çështjeje kaq me rëndësi. Për të satën herë u kuptua se udhëheqja jonë është analfabete për këso punë, ndërkohë që pjesa më e madhe e opozitës jeton me shpresë se bisedimet mund të shtyhen për ndonjë kohë dhe situatë më të volitshme për të", ka vlerësuar

Gorani. Në këtë intervistë, ai ka folur edhe për rolin që presidenti i vendit do ta ketë në këtë proces sipas këtyre dy dokumenteve. "Roli i presidentit mbetet ai që e përcakton Kushtetuta e Republikës, përfaqësimi i vendit. Por, jo edhe udhëheqja e bisedimeve kaq të rëndësishme. Kjo nuk parashihet e as nuk nënkuptohet në Kushtetutë. Kosova nuk ka sistem presidencial, andaj nuk duhet të humbim kohë duke diskutuar diçka të kotë", ka thënë Gorani.

**"Epoka e re": Z. Gorani, PSD-ja ka dorëzuar në Kuvend një projektrezolutë dhe një projektligj për dialogun me Serbinë. Çfarë përmbajnë këto dokumente?**

**Gorani:** Projektrezoluta e PSD-së e formëson institucionin negociator të Kosovës për procesin e dialogut. Me të qartësohen mandati, përfaqësimi, vendimmarrja dhe llogaridhënia në delegacionin shtetëror. Po ashtu, fuqizimi i saj realizohet përmes Projektligjit për Dialogun i cili duhet të votohet

në Kuvend. Këto dy dokumente janë të ndërlidhura njëri me tjetrin. Rezoluta pa ligj nuk ka fuqi detyruese, kurse Ligji pa Rezolutë nuk ka kuptim politik.

**"Epoka e re": Pse pikërisht tash dolët me këtë propozim. Cili është qëllimi?**

**Gorani:** PSD-ja dhe grupi i saj parlamentar e kupton dialogun me Republikën e Serbisë si proces të paevitueshëm, edhe pse i padrejtë politikisht dhe historikisht. Presioni ndërkombëtar për nisjen sa më të shpejtë të tij parakupton përgatitje serioze dhe strukturim të mënyrës se si do të funksionojë përfaqësimi ynë shtetëror atje. Tash e një vit, ajo që pamë nga pushteti vendor ishte amatorizëm politik dhe paaftësi qeverisëse karshi një çështjeje kaq me rëndësi. Për të satën herë u kuptua se udhëheqja jonë është analfabete për këso punë, ndërkohë që pjesa më e madhe e opozitës jeton me shpresë se bisedimet mund të shtyhen për ndonjë kohë dhe situatë më të volitshme për të. Me hartimin e Projektrezolutës dhe Projektligjit mbi Dialogun,

**EPOKA E RE****Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 9 DHJETOR - Deputeti dhe nënkryetari i Partisë Socialdemokrate, Dukagjin Gorani, ka deklaruar se kjo parti politike nuk do të pranojë që në mënyrë të pjesshme t'i miratohen në Kuvend dokumentet e saj për dialogun me Serbinë. Ai ka bërë me dije se projektrezoluta dhe projektligji për dialog i këtij subjekti politik mund të

pranohen në tërësi nga Kuvendi ose të refuzohen në tërësi. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Gorani ka thënë se çdo gjë tjetër është humbje kohe dhe dëshmi e mosdijes politike. "Këtu ka vetëm dy zgjidhje: ose ta hedhin poshtë në tërësi përpjekjen e PSD-së ose ta pranojnë në tërësi. Çdo gjë tjetër është humbje kohe dhe dëshmi e mosdijes politike", ka thënë Gorani.

Ai ka treguar se dy dokumentet

# Uk negociohet

bisedimet nën mbikëqyrje të tij. Dokumentet që i hartoi PSD-ja ofrojnë një zgjidhje kredibile dhe rrugëdalje nga paraliza e sotme e shkaktuar nga mosdija pushtetore dhe bllokimi opozitar.

**"Epoka e re":** Deri më tani AAK-ja dhe Nisma kanë dalë në mbështetje të kësaj përpjekje, por PDK-ja është shprehur më hezituese për kufizimin e rolit të presidentit në këtë proces. E keni diskutuar këtë çështje me PDK-në?

**Gorani:** PDK-në e ka bllokuar ndikimi i presidentit Thaçi mbi udhëheqjen e saj. Ai po i interpreton dokumentet e PSD-së si suprimim i mandatit të vet. Kjo është e pakuptimtë meqë ai nuk ka mandat negociues. Këtu ka vetëm dy zgjidhje: ose ta hedhin poshtë në tërësi përpjekjen e PSD-së ose ta pranojnë në tërësi. Çdo gjë tjetër është humbje kohe dhe dëshmi e mosdijes politike.

**"Epoka e re":** Dy subjektet e tjera opozitare e kanë kundërshtuar këtë iniciativë tuajën. Madje zyrtarët e këtyre subjekteve e kanë kritikuar PSD-në për këtë veprim, duke thënë se po i shërbejnë pushtetit. Cili është komenti juaj?

**Gorani:** Nuk i komentoj qëndrimet e subjekteve të tjera. Në këtë tregun kaotik të politikës parlamentare, PSD-ja i hartoi dhe i ofroi dy dokumente/formulime që do të mund të përdreshin për ta ndërtuar një angazhim efikas në bisedime. Këto mund të pranohen ose të refuzohen. Nuk shoh nevojë që ato të përdoren për dramatizime, ofendime dhe cirkus publik. Nëse dikush ka ide më të mira, le t'i hartojë dhe le t'i ofrojë. Tash e një vit dëgjuam vetëm grindje dhe sharje, duke mos u ofruar asnjëherë diçka e shkruar dhe kuptimplotë.

PSD-ja u përpoq ta tejkalojë këtë qorrsoyak tradicional. Përmes tyre, PSD po ofron ndërtimin e një mekanizmi efikas negociator në situatën kur bisedimet duken të pae-vitueshme, ndërkohë që udhëheqja e paaftë politike përbën një fakt shoqëror.

**"Epoka e re":** Këto dokumente po shihen në opinion si përpjekje për ta kufizuar rolin e presidentit në dialogun me Serbinë. Si do të arrihet kjo?

**Gorani:** Roli i presidentit mbetet ai që e përcakton Kushtetuta e Republikës - përfaqësimi i vendit. Por, jo edhe udhëheqja e bisedimeve kaq të rëndësishme. Kjo nuk parashihet e as nuk nënkuptohet në Kushtetutë. Kosova nuk ka sistem presidencial, andaj nuk duhet të humbim kohë duke diskutuar diçka të kotë. Presidenti dhe institucionet e tjera kushtetuese janë të rëndësishme në përfaqësim formal, por jo edhe për negociim. Për këso situata të veçanta historike, Kuvendi i Republikës mandaton një delegacion shtetëror i cili zhvillon

**"Epoka e re":** A do të pranohet PSD-ja të bëhet pjesë e procesit të dialogut me Serbinë nëse LDK-ja dhe LV-ja refuzojnë një gjë të tillë?

**Gorani:** Po, nëse pushteti i pranon propozimet tona dhe nëse ato marrin shumicën e votave në Kuvend. Qëndrimet e LDK-së dhe të LV-së janë e drejtë dhe çështje e tyre. Ato e shohin ndryshe zgjidhjen e këtij procesi të ndjeshëm politik dhe historik. Mbase mund të dalë që e kanë mirë. Sidoqoftë, në situatën aktuale të presioneve ndërkombëtare dhe të paaftësisë qeveritare, u dashtë që dikush të ofrojë diçka. Partia Socialdemokrate e mori mundin të hartojë diçka në letër. Por, ato që po vazhdojmë të dëgjojmë janë vetëm fjalë.

# Kosova këtë javë pritet të bëhet me ushtri

Republika e Kosovës në fund të kësaj jave pritet të bëhet me ushtri. Pakon e tri projektligjeve për transformimin e FSK-së në ushtri, Kuvendi i Kosovës do ta votojë në seancë e së premtes. Subjektet politike shqiptare kanë bërë me dije se do t'i votojnë këto projektligje, kurse ambasadori i ShBA-së në Kosovë, Philip Kosnett, i ka dhënë mbështetje transformimit të FSK-së

**EPOKA E RE**

**Faton DËRMAKU**

**PRISHTINË, 7 DHJETOR** - Institucionet e Kosovës për formimin e ushtrisë nuk do t'i ndalë hezitimi i NATO-s dhe disa vendeve anëtare të kësaj aleance. Pas bekimit të ShBA-së për këtë proces, Kuvendi i Kosovës të premten pritet ta votojë në lexim të dytë pakon e projektligjeve për transformimin e FSK-së në ushtri. Liderët institucionalë kanë përsëritur edhe një herë se ushtria e Kosovës do të jetë ushtri e paqes në Ballkan, por edhe në zona të tjera kudo që do të kërkohet angazhimi i saj për ruajtjen e paqes. "FSK-ja ka arritur standardet më të larta profesionale dhe natyrisht edhe pak ditë do ta bëjmë ushtri të Kosovës", ka thënë Veseli gjatë vizitës së tij në ShBA.

Edhe kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka rithek-suar se nuk ka asnjë dilemë rreth votimit të tri projektligjeve për transformimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës në kapacitete ushtarake, më 14 dhjetor. "NATO-ja është organizatë e disa vendeve të sigurisë dhe mendimi i një

anëtarit të NATO-s nuk kthehet në vendim, në fakt vendimet merren vetëm kur të gjithë janë dakord, kështu që neve nuk na pengon puna me NATO-n. Nëse kjo është një kërkesë dhe nuk aprovohet nga të tjerët, kjo nuk ndryshon asgjë", ka thënë Haradinaj, duke shtuar se qëndrimi i ShBA-së është për më shumë stabilitet në Kosovë dhe në rajon. "Ka qenë në vazhdimësi ky qëndrim. Këtë e ka shprehur edhe ambasadori amerikan në Kosovë, Philip Kosnett, pra është në linjë me deklaratet e mëhershme të zyrtarëve të Departamentit të ShBA-së, ku edhe në Beograd kanë thënë që Kosova do të ketë ushtrinë", ka deklaruar kryeministri Haradinaj. Ditë më parë sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, ka paralajmëruar Kosovën se do të "përballet me pasojat serioze nëse vazhdon transformimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës në ushtri të Kosovës". Sipas Stoltenbergut, ky proces po udhëhiqet "në një moment mjaft të papërshtatshëm, pa u respektuar procedurat". Ndërkaq ambasadori i ri i

ShBA-së në Kosovë, Philip Kosnett, ka thënë në një intervistë për Radio Televizionin e Kosovës se Uashingtoni ka mbështetur zhvillimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe zhvillimin e saj në Forcë të Armatosur. Kosnett ka thënë se, pavarësisht prej shqetësimeve të vendeve fqinje për evoluimin e FSK-së në Forcë të Armatosura, "Kosova ka çdo arsye dhe ka të drejtë të ketë aftësi vetëmbrojtëse". Edhe ish-ambasadori i Holandës në Kosovë, Robert Bosch, ka reaguar ndaj deklaratës së sekretarit të përgjithshëm të NATO-s, Jens Stoltenberg, sipas së cilës, transformimi i FSK-së në ushtri nuk është duke ndodhur në kohën e duhur. "Pajtohem plotësisht me mikun tim Serwer, pse nuk duhet të ketë ushtri një vend i pavarur? Nuk është kundër askujt (ushtria) dhe është shumetnike, nëse Beogradi nuk do të bënte presion te serbët që të mos bashkohen me të. Dhe sigurisht jo njësi e UÇK-së që duhet çarmatosur. Turp për ju znj. Brnabiq dhe për luftënxitjen nga ana juaj", ka shkruar Bosch në llogarinë e vet në "Facebook".



# Rreth pesë mijë raste të vjedhjeve ndaj pronave të qytetarëve

Sipas përfaqësuesve të Policisë së Kosovës, rajoni i Prishtinës është më i rrezikuari nga grabitjet e armatosura. Gjatë periudhës janar-tetor në rajonin e Prishtinës kanë ndodhur 59 raste të grabitjeve të armatosura



**PRISHTINË, 9 DHJETOR** - Rreth pesë mijë raste të vjedhjeve të kryera janë shënuar këtë vit në Kosovë. Statistikat, të cilat publikohen nga policia, përmbajnë të dhëna për dhjetë muaj. Në këto raste shqetësues thuhet se është numri i grabitjeve me armë zjarri ku, pos dëmeve materiale dhe pronësore, rrezikohet edhe jeta e qytetarëve.

Sipas zëdhënësit të Policisë së Kosovës, Daut Hoxha, rajoni i Prishtinës është më i rrezikuari nga grabitjet e armatosura. "Gjatë kësaj periudhe kohore, janar-tetor, në regjionin e Prishtinës kanë ndodhur 59 raste të grabitjeve të armatosura, kurse në të gjitha regjionet e tjera kanë ndodhur shumë më pak grabitje të armatosura, konkretisht në banka janë shënuar gjashtë raste. Në këto gjashtë raste, shtatë persona janë të dyshuar, nga këta janë arrestuar tre të dyshuar", ka thënë Hoxha.

Sipas Hoxhës, përveç pjesëtarëve të rregullt patrullues, forcat e rendit kanë të angazhuar edhe njësitet e hetimeve të cilat merren me trajtimin dhe hetimin e rasteve të vjedhjeve dhe grabitjeve, për ta mbrojtur

jetën dhe pronën e qytetarëve dhe ofruar siguri të përgjithshme. "Policia, pas hetimeve intensive për zbardhjen dhe arrestimin e kryerësve të këtyre veprave, ka goditur 13 grupe kriminale që dyshohet që janë përfshirë në këto raste, janë arrestuar 32 persona të dyshuar të cilët janë në paraburgim, prej tyre ka persona që dyshohet se kanë kryer më shumë se dy grabitje, kurse gjashtë të dyshuar të tjerë, të identifikuar nga policia, janë në arrati", ka thënë zëdhënësi i policisë.

Përderisa shprehet i shqetësuar me gjendjen, njohësi i çështjeve të sigurisë, Avni Islami, ka theksuar se për shkak të

neglizhencës së institucioneve, të cilat, sipas tij, e kanë lënë anash çështjen e sigurisë, po rrezikohet edhe jeta dhe prona e qytetarëve. Sipas tij, një prej hapave të parë dhe urgjent është vendosja e kamerave të sigurisë në rrugë, në të gjitha qytetet. "Duhet që urgjentisht institucionet e Kosovës, komunitat, t'i vendosin kamerat e sigurisë dhe nga zyrat përkatëse të monitorohet komplet qyteti nga policia e Kosovës, sepse kjo do të ndikonte edhe në aspektin psikologjik të grupet e organizuara kriminale, të cilave në vetëdijen e tyre do t'u ngulitej në kokë se janë të monitoruar 24 orë. Dhe që të kryhet një vjedhje

profesionale në pikë të ditës, nuk kanë ku të shkojnë dhe se do të arrestohen nga policia", ka thënë Islami.

Lidhur me këtë, Islami vlerëson se institucionet shtetërore kanë dështuar t'i neutralizojnë grupet e organizuara kriminale. Ai ka kërkuar hartimin e një strategjie për përmirësimin e gjendjes dhe propozon edhe ndryshime ligjore, të cilat do t'u jepnin qytetarëve më shumë të drejta për vetëmbrojtje kur përballen me grabitjet e armatosura. "Familjari duhet të mëveshët me ligj, t'i lejohet të përdoret arma e zjarrit në vetëmbrojtje ekstreme, sikurse që ka ndodhur rasti i fundit.

Kemi shumë raste, si në 'Albi Mall, dhe raste të tjera, kur punëtorët e sigurimit ekzekutohen për shkak nuk kanë qenë të armatosur, nuk e kanë pasur mundësinë as të vetëmbrohen nga bandat kriminale", ka theksuar Islami.

Ditët e fundit në Prishtinë një person ka qëlluar për vdekje me armë zjarri një person tjetër që i kishte hyrë në pronë dhe dyshohej se po kryente një vjedhje. Më herët gjatë këtij viti, ka pasur disa raste, kur gjatë kryerjes së vjedhjes hajnat kanë vrarë pronarët e shtëpive dhe rojet e bizneseve. Vitin e kaluar në tërë Kosovën janë regjistruar 5 735 raste të veprës penale vjedhje.

## Arrestohen dy shtetas të huaj për falsifikim të parave



**PRISHTINË, 9 DHJETOR (ER)** - Policia e Kosovës ka arrestuar dy shtetas të huaj nën dyshimin për falsifikim të parave. Përmes një njoftimi për media, policia ka njoftuar se më 7 dhjetor ka pranuar informacione se dy persona të dyshuar, shtetas të huaj, kanë tentuar t'i mashtrorjnë pronarët e dy këmbimoreve në Prishtinë, "duke tentuar të këmbëjnë kartëmonedha të euros të dyshuara si të falsifikuara me kartëmonedha të dollarit amerikan". "Gjatë kontrollit që u është bërë

personave të dyshuar është vërejtur se të njëjtit kanë kartëmonedha (valuta nga shtete të ndryshme) të tjera e të cilat dyshohet se edhe ato janë të falsifikuara. Ka ekzistuar dyshimi i arsyeshëm se të dyshuarit kanë kryer veprën penale 'Falsifikim i parasë' sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës", thuhet në komunikatë.

Dy të arrestuarve, të cilët janë dërguar në mbajtje, u janë konfiskuar gjithsej 4 910 euro, 2 484 dollarë amerikanë dhe 440 lira turke.

Të dielën u bë një vit nga vdekja e artistit Blerim Peci

# Artisti Blerim Peci do të kujtohet përgjithmonë

Të dielën është mbajtur akademi përkujtimore me rastin e njëvjetorit të vdekjes së artistit, Blerim Peci. Të pranishëm në këtë akademi përkujtimore ishin përfaqësues të institucioneve të Republikës së Kosovës, deputetë, aktorë, familjarë të artistit Blerim Peci dhe përfaqësues të tjerë. Në fund të kësaj akademie është shfaqur dokumentari "Përgjithmonë" kushtuar artistit Blerim Peci

## "Epoka e re"

PRISHTINË, 9 DHJETOR - Nën përkujdesjen e ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, të dielën është mbajtur akademja përkujtimore me rastin e njëvjetorit të vdekjes së artistit, Blerim Peci. Të pranishëm në këtë akademi përkujtimore ishin përfaqësues të institucioneve të Republikës së Kosovës, deputetë, aktorë, familjarë të artistit Blerim Peci dhe përfaqësues të tjerë. Me këtë rast ministri Gashi ka thënë se rrugëtimi për të arritur deri te figura publike ishte dhe është shumë e vështirë për të gjithë, por "Blerimi (Beli), siç

e njohim, do të jetë përgjithmonë në kujtesën tonë si aktor i njohur dhe i pranuar për publikun". "Familjarë, aktorë dhe kolegë të Blerim Pecit, sot po e përkujtojmë, në njëvjetorin e vdekjes, të afërmin tuaj dhe ish-mikun tonë. Kujtimet tona dhe të publikut për ta njohur Blerimin filluan në shfaqjet e tij brilante në projektin 'Thyerja', ku rolin e kishte 'I dehuri'. Nga këtu fillon publikimi i talentit të tij dhe njohja me publikun", ka thënë ministri Gashi. Ai ka shtuar se pjekuria e aktrimeve të tij është parë në aktrimet e "ShowMeseleton", në Mitrovica Stars", në "Vitin e ri artistik", pastaj në "Taletin X" dhe ne të gjithë i kemi kujtimet



e freskëta për aktrimin e tij në projektin televiziv "Vikendi" e shumë përfaqësime të tjera të cilat frymuan lirinë e tij artistike. "Përveç rrugës së aktrimit, ai intervistoi në një program 'Udhëtimi në kohë' disa kryetarë komunash, deputetë etj., të cilat biseda kishin një qasje tjetër nga ajo e gazetarisë së rëndomtë. Aktivitetet e Blerim Pecit do të mbeten për-

jetësisht në kujtesën tonë dhe do të jenë inspirim për aktorët dhe aktruesit e rinj. Kujtimet për Blerim Pecin qofshin gjithmonë të paharruara", ka deklaruar ministri Gashi. Drejtori i Radio Televizionit të Kosovës (RTK), Mentor Shala, ka thënë se në televizionin publik po ndihet mungesa e Blerim Pecit. "Po vërehet mungesa e emisioneve të veçanta të tij që i ka pasur. Publikut të Kosovës po i mungon shumë Beli. Për nder të vlerave që kanë pasur emisionet e tij, unë, në bazë të kompetencave që kam si drejtor i RTK-së, kam vendosur që në kuadër të çmimeve që i ndan RTK-ja për personalitetet e vitit për kontributin që kanë dhënë në fushën e televizionit dhe radios, një nga çmimet ta

mbajë emrin e Blerim Pecit. I përjetshëm qoftë kujtimi për të!", ka thënë Shala. Bashkëshortja e tij, Afërdita Sopjani-Peci, ka falënderuar të pranishmit dhe të gjithë ata që iu gjenden pranë për t'ia lehtësuar dhimbjen për bashkëshortin e saj, artisin Blerim Peci. "Për të folur për Belin ka shumë, por është e vështirë për t'i zgjedhur fjalët. Për atë çfarë kemi pasur për të thënë për Belin e keni rastin për ta shikuar dokumentarin 'Përgjithmonë'", ka thënë Afërdita Sopjani-Peci. Në fund është shfaqur dokumentari "Përgjithmonë", i realizuar nga RTK-ja, autore e këtij dokumentari ishte bashkëshortja e artistit Blerim Peci, Afërdita Sopjani-Peci, kurse regjia është bërë nga Kastriot Saqipi-"Kaqa".



## Veseli nderon vëllezërit Bytyçi

NJU JORK, 9 DHJETOR (ER) - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, gjatë qëndrimit në Nju Jork, së bashku me ish-bashkëluftëtarët nga Batalioni "Atlantiku", ka bërë homazhe dhe ka vendosur lule pranë varreve të tre ish-pjesëtarëve të UÇK-së, vëllezërve Yll, Agron dhe Mehmet Bytyçi, të vrarë nga forcat serbe pas përfundimit të luftës në Kosovë.

Kreu i Kuvendit ka thënë se përlulja para këtyre tre heronjve tregon se sa shumë është dashur të jepet për të arritur këtu ku jemi sot. Veseli ka theksuar se liria është e shenjtë dhe e shtrenjtë, prandaj duhet punuar edhe më shumë për ta ruajtur atë që është arritur dhe njëkohësisht për ta vazhduar edhe më fuqishëm kultivimin e partneritetit me ShBA-në edhe për faktin se ky vend ua ka dhënë mundësinë të gjithëve. "Vetëm 19 vjet më herët demonstroi, dilnit në mënyrë ushtarake për t'u nisur në drejtim të rrugëtim-

it të lirisë, luftës së UÇK-së dhe çlirimit të vendit tonë, Kosovës. Ne do ta vazhdojmë këtë partneritet. Jemi falënderues ndaj ShBA-së, ndaj partnerëve tanë dhe do ta vazhdojmë bashkërisht fuqizimin e shtetit. Nuk ka kush që na ndalë", ka thënë kryeparlamentari Veseli. Kryetari i Kuvendit ka deklaruar se shteti ynë është i shenjtë sikurse janë të shenjtë sovraniteti dhe integriteti territorial. Ai shtoi se do të punohet, së bashku me partnerët, që shtetin ta kemi edhe më të fuqishëm në aspektin ekonomik, demokratik dhe ligjor. "Ju duhet të jeni krenarë për kontributin që keni dhënë për lirinë e Kosovës", është shprehur Veseli. Kreu i Kuvendit ka thënë se duhet ruajtur dhe çuar përpara amaneti i këtyre tre heronjve, të rënë në altarin e lirisë. "Jam shumë krenar që sot, si bashkëluftëtar i tyre, bashkëluftëtar i juaji, vij në krye të institucionit të përfaqësuesve



të popullit të Kosovës, Kuvendit të Republikës së Kosovës, të ndaj dhe të përkulemi bashkë-

isht para sakrificës së popullit tonë, para këtyre heronjve të lirisë. Lavdi heronjve të UÇK-së!

Lavdi sakrificës së popullit tonë!", ka thënë kryetari i Kuvendit, Kadri Veseli.

# Fillojnë përgatitjet për hapjen e zyrës së Doganës së Kosovës në portin e Durrësit



PRISHTINË, 9 DHJETOR (ER) - Grupet teknike kanë filluar procedurat për hapjen e zyrës së Doganës në Portin e Durrësit. Në kuadër të bashkëpunimit të dy qeverive, si dhe në kuadër të zbatimit të vendimeve të dy qeverive më 7 dhe

8 dhjetor në Tiranë dhe Durrës, drejtori i përgjithshëm i Doganës, Bahri Berisha, me bashkëpunëtorë ka takuar drejtoreshën e përgjithshme të Doganës së Shqipërisë, Belinda Ikononi. Gjatë këtij takimi ishin të pranishëm

edhe dy grupet punuese të administratave doganore, të cilat kanë diskutuar mbi procedurat teknike për hapjen e zyrës së Doganës së Kosovës në Portin e Durrësit. Krahas takimeve u bë edhe vizita në portin e Durrësit, ku me këtë

rast u përcaktuan zyrat dhe ambientet e punës për Doganën e Kosovës, të cilat do t'i zhvillojnë procedurat doganore të transitit. Hapja e kësaj zyre do ta lehtësojë tregtimin, lëvizjen e mallrave, po edhe atë të udhëtareve. Kjo pritet ta

shkurtojë koston e bizneseve si dhe të ndihmojë rritjen e ekonomive të dy vendeve përmes thellimit të bashkëpunimit. Procedurat doganore në Portin e Durrësit nga Dogana e Kosovës do të fillojnë që nga muaji janar 2019.

## Mbi 75 për qind e bizneseve besojnë se korrupsioni në Kosovë është sistemor

PRISHTINË, 9 DHJETOR (ER) - Në Ditën Ndërkombëtare Kundër Korrupsionit, Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë (OEAK) shpreh shqetësimin lidhur me transparencën në rënie dhe angazhimin e ulët të Qeverisë së vendit dhe të institucioneve të tjera shtetërore për luftimin e korrupsionit. "Pavarësisht prej thirrjeve të vazhdueshme për një luftë më të efektshme kundër kësaj dukurie e cila cenon zhvillimin ekonomik, retorika e zotimeve dominon veprimet e mangëta në këtë drejtim. Arritja e rezultateve konkrete për luftimin e korrupsionit do të ishte dëshmi e përkushtimit të institucioneve përgjegjëse për heqjen e një njolle që vazhdon ta pasqyrojë

vendin në raporte të organizatave prestigjioze ndërkombëtare dhe vendore. Raportimet e tilla zvogëlojnë mundësitë e tërheqjes së investimeve të huaja, ndërsa viti 2018 sjell shifra shqetësuese në këtë drejtim", është thënë në reagimin e OEAK-ut. Studimi i fundit i Odës Amerikane mbi perceptimin e korrupsionit ka gjetur se mbi 75 për qind e bizneseve besojnë se korrupsioni në Kosovë është sistemor, derisa faktorët që mundësojnë korrupsionin janë sundimi i dobët i ligjit, mungesa e vullnetit politik për ta luftuar korrupsionin dhe korniza e mangët ligjore, derisa mbi 50 për qind e bizneseve të anketuara besojnë se niveli i korrupsionit



ka mbetur i njëjtë krahasuar me pesë vjet më parë. Studimi, po ashtu, ka gjetur se institucionet në të cilat bizneset janë ballafaquar me korrupsion përfshijnë ministrinë e linjës, ndërmarrjet publike, zyrtarët

tatimorë, institucionet e drejtësisë dhe komunat. Oda Amerikane vlerëson se një gjyqësor efikas dhe llogaridhënës do të ishte jetik për çrënjosjen e korrupsionit, derisa perceptimi mbi institucionet e

korruptuara të drejtësisë rrënon besimin e bizneseve dhe dekurajon rolin e tyre aktiv për raportimin e veprimeve korruptive. Studimi mbi perceptimin e korrupsionit ka gjetur se vetëm 15 për qind e bizneseve kanë raportuar rastet e korrupsionit tek autoritetet përkatëse. Oda Ekonomike Amerikane beson se asnjë prioritet tjetër nuk do të duhej ta linte në hije luftën kundër korrupsionit meqë një mjedis pa korrupsion do të ofronte prospekte të barabarta zhvillimore për bizneset e vogla dhe të mesme, do t'i rriste mundësitë e tërheqjes së investimeve të huaja direkte, rrjedhimisht do të ofronte edhe mundësi reale për vende të reja të punës.



# Bizneset kërkojnë rinegocim të pozitës së Kosovës në CEFTA



Përfaqësuesit e bizneseve në Kosovë kanë kërkuar që të rinegociohet marrëveshja e CEFTA-s, përkatësisht pozicioni juridik dhe ekonomik i Kosovës në CEFTA. Skënder Krasniqi nga Oda e Afarizmit dhe Berat Rukiqi nga Oda Ekonomike e Kosovës kanë theksuar se kjo marrëveshje vazhdon të jetë e disfavorshme për prodhuesit vendorë

**EPOKA ERE** Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 9 DHJETOR - Përfaqësuesit e bizneseve në Kosovë kanë kërkuar të rinegociohet marrëveshja e CEFTA-s, përkatësisht pozicioni juridik i Kosovës në CEFTA, ku Kosova përfaqësohet si UNMIK e jo si republikë. Pas përfaqësimit të Kosovës me të drejta jo të barabarta, sipas Skënder Krasniqit nga Oda e Afarizmit dhe Berat Rukiqit nga Oda Ekonomike e Kosovës, kjo marrëveshje vazhdon të jetë e disfavorshme për prodhuesit vendorë andaj, sipas tyre, duhet të kërkohet edhe mbrojtja e prodhimeve vendorë kundër pozicionit juridik.

Kryetari i Lëvizjes për Bashkim, Valon Murati, ka thënë për gazetën "Epoka e re" se është momenti që Kosova të tërhiqet nga CEFTA si UNMIK dhe të aplikojë si shtet me të drejta të barabarta. Ai ka treguar se para disa ditësh ka dhënë një propozim që Qeveria e Kosovës ta trajtojë me seriozitet çështjen e tërheqjes nga CEFTA, pasi aty po paraqitet si UNMIK.

Murati ka thënë se pas taksës 100 për qind ndaj produkteve të Serbisë do të ishte mirë të shndërrohej një embargo ekonomike ndaj Serbisë. "Do të ishte mirë që në të tërhiqemi nga CEFTA, pastaj të aplikojmë si shtet me të drejta të plota", ka thënë Murati. Ai ka thënë se në këtë drejtim nuk duhen bërë

hapa të ngutshëm. "Qeveria në kuadër të masave që është duke i trajtuar, duhet ta trajtojë edhe këtë çështje. Kushtimisht, pasi veçse ka filluar kjo luftë politike me Serbinë, Kosova duhet ta çojë deri në fund çështjen e tërheqjes nga CEFTA si UNMIK dhe aplikimit si shtet me të drejta të plota. Pra, që Kosova të pranohet si republikë me të drejta të plota dhe jo përmes UNMIK-ut. Pastaj aplikohen mekanizma të caktuar që kur të bëhet marrëveshja për të hyrë në CEFTA mund të gjesh mundësi të mbrojtjes së ndonjë produkti apo sektori të caktuar. Problemi qëndron se Kosova nuk e ka bërë marrëveshjen dhe nuk ka hyrë drejtpërdrejt në marrëdhënie kontraktuale. Është krejt ndryshe kur ne si shtet hyjmë dhe bëjmë marrëveshje dhe i mbrojmë interesat tona në fushën e ekonomisë në kuadër të CEFTA-s", ka thënë Murati.

Ndërkaq kryetari i Odës së Afarizmit të Kosovës (OAK), Skënder Krasniqi, ka thënë për gazetën "Epoka e re" se Oda e Afarizmit vazhdon të mbetet konsistente në kërkesën për tërheqje të Kosovës nga CEFTA, ku shteti ynë figuron si UNMIK. Krasniqi ka thënë se pozita aktuale e Kosovës në CEFTA

është antikushtetuese dhe e disfavorshme për ekonominë vendorë. "Që nga fillimi Oda e Afarizmit ka kërkuar që Kosova të dalë nga CEFTA si UNMIK dhe t'i fillojë negociatat për hyrje si Republikë e Kosovës, duke filluar kështu të mbrohen produktet vendorë. Kur është nënshkruar marrëveshja e CEFTA-s në vitin 2006, Kosova ka qenë i vetmi vend që asnjë produkt nuk e ka mbrojtur, ndërkohë që shtetet e tjera kanë mbrojtur me qindra produkte. Pra, kjo ka ndikuar që mos të zhvillohet ekonomia jonë, por ka filluar shkatërrimi i të gjitha produkteve", ka deklaruar Krasniqi. Ai ka thënë se produktet në Kosovë nga të gjitha vendet kanë hyrë me doganë zero. "Kjo marrëveshje e ka dëmtuar zhvillimin tonë menjëherë pas pavarësisë dhe, në anën tjetër, ka bërë rritje të hyrave nga shtetet e CEFTA-s në Kosovë", u shpreh ai. Krasniqi ka thënë se duhet të diskutohet që të mbrohen të gjitha produktet e Kosovës dhe të trajtoheni si shtet me të drejta të barabarta. Ai ka theksuar se Kosova duhet të punojë për rritjen e identitetit të saj ekonomik. Kurse kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës (OEK), Berat Rukiqi, ka thënë për gazetën "Epoka e re" se Kosova duhet të ripoziciono-

het në CEFTA. "Duhet të ripozicionohemi dhe nuk mund të jetë më përfaqësimi përmes UNMIK-ut. Duhet ta kemi mundësinë ta kemi një ripozicionim në kuptimin e eliminimit të barrierave. Tash është vonë të dalim nga CEFTA, pasi marrëveshja e CEFTA-s është pjesë e Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit dhe nuk e kemi komoditetin për të dalë nga kjo marrëveshje", ka thënë Rukiqi, duke shtuar se duhet të ketë vendim politik për pozicionimin e Kosovës në CEFTA. "Duhet vendim politik i komitetit të përbashkët të CEFTA-s dhe kjo duhet të jetë një nga kushtet për ta hequr taksën, në mënyrë që Serbia ta pranojë Kosovën si palë dhe jo si UNMIK. Sa iu përket mekanizmave, duhet të shohim ku mund të fitojmë. Pra, është protokoli 5 për lehtësimin e tregtisë dhe protokoli 7 për zgjedhjen e konteksteve tregtare", ka thënë Rukiqi. Mbledhja e Komitetit Ndërmator të CEFTA-s, e cila ishte paraparë të mbahej javën që lamë pas në Prishtinë, është shpallur e mbyllur nga kryesuesi i Kosovës, Durim Limaj, pasi përfaqësuesi nga Serbia i është referuar Kosovës si "institucion i përkohshëm dhe UNMIK".

## Pastrohet shtati i lumit në fshatin Bajçinë

PODUJEVË, 9 DHJETOR (ER) - Komuna e Podujevës përmes kompanisë së kontraktuar është duke vazhduar pastrimin dhe zgjerimin e shtretërve të lumenjve dhe hapjen e pastrimit të kanaleve të ujit. Të dielën ka përfunduar pastrimi i shtetit të lumit në fshatin

Bajçinë, ndërsa ditë më parë ka përfunduar edhe pastrimi i disa kanaleve në fshatin Gerdoc. Largimi i deponive dhe pastrimi i shtretërve të lumenjve dhe hapja e kanaleve po bëhet edhe në kuadër të aksionit "Ta pastrojmë Kosovën".



## Një delegacion i qytetit të Sarandës viziton Gjakovën

GJAKOVË, 9 DHJETOR (ER) - Një delegacion nga qyteti i Sarandës, i prirë nga kryetarja e baskisë, Florjana Koka, kanë qëndruar për një vizitë në qytetin e Gjakovës. Gjatë kësaj vizite mysafirët nga Saranda janë pritur në takim nga kryetari i Gjakovës, Ardian Gjini. Në njoftimin e Komunës së Gjakovës është thënë se këto dy komuna, sikurse të gjitha komunat e tjera në Kosovë dhe Shqipëri, kanë nevojë për më shumë vizita dhe takime të këtij lloji, pasi qytetarët në të dyja anët e kufirit kanë nevojë për

njohje dhe miqësi më të madhe me njëri-tjetrin. "Në frymën e kësaj, udhëheqësit e dy qyteteve janë pajtuar që ta rrisin bashkëpunimin konkret, duke filluar nga ekskursioni i organizuar i nxënësve në të dyja qytetet, pastaj bashkëpunimi në aspektin ekonomik e deri te ofrimi i përvojave profesionale nga profesionistë të shumtë të të dyja qyteteve", ka njoftuar Komuna e Gjakovës. Për t'u njohur më shumë me historinë, traditën dhe kulturën e qytetit të Gjakovës, mysafirët nga Saranda, të shoqëruar nga

zyrtarët komunalë, kanë vizituar disa prej institucioneve më të rëndësishme të trashëgimisë, atyre kulturore dhe fetare, siç janë: Xhamia e Hadumit, Teqeja e Bektashive dhe ajo e sheh Eminit, Pallati i Kulturës "Asim Vokshi", Biblioteka "Ibrahim Rugova", Shkolla e Muzikës "Prenk Jakova" etj. Të dy delegacionet kanë bërë homazhe dhe kanë vendosur kurora me lule te lapidari "Shokët e Lirisë", duke nderuar kështu të gjithë heronjtë dhe dëshmorët e Komunës së Gjakovës.



## Komogllava e Ferizajt bëhet me rrugë të asfaltuara

FERIZAJ, 9 DHJETOR (ER) - Në fshatin Komogllavë të Komunës së Ferizajt janë asfaltuar disa rrugë. Asfaltimin e këtyre rrugëve e ka përcjellë kryetari i Ferizajt, Agim Aliu, i shoqëruar edhe nga drejtori i Infrastrukturës, Arbër Bytyqi. Me këtë rast, Aliu ka thënë se edhe në këtë zonë po investohen projekte të rëndësishme infrastrukturore

për t'ua ofruar përfundimisht banorëve të këtij fshati dhe fshatrave përreth infrastrukturën e munguar ndër vite. Edhe drejtori i Drejtorisë së Infrastrukturës, Arbër Bytyqi, ka thënë se banorët e këtij fshati e kanë vuajtur gjatë mungesën e investimeve infrastrukturore. "Jemi në fshatin Komogllavë, ndërsa po bëjmë përfundimin e

një projekti i cili është filluar muaj më parë. Tani po bëhet asfaltimi i 20 rrugicave në këtë fshat, ndërsa bëhet fjalë për një projekt rreth 400 mijë euro", është shprehur drejtori Bytyqi. Banorët e këtij lokaliteti e kanë mirëpritur asfaltimin e rrugëve të tyre. U bë e ditur se asfaltimi i rrugëve në fshatin Komogllavë është projekt trevjeçar.

## Vazhdon aksioni për eliminimin e deponive ilegale në Drenas

DRENAS, 9 DHJETOR (ER) - Komuna e Drenasit, përkatësisht Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë, është duke vazhduar aksionin për eliminimin e deponive ilegale. Si vazhdimësi e këtij aktivitetit, në fundjavën e kaluar është bërë eliminimi i deponisë në

fshatin Fushticë të Ulët dhe Sankoc. Komuna e Drenasit është duke vazhduar me intensitet të shtuar eliminimin e deponive duke angazhuar edhe dy kompani të tjera private për eliminimin e të gjitha deponive që janë në territorin e kësaj komune.



# UÇK-ja ka përfunduar detyrën në vitin 1999



**Rustem MUSTAFA**

Vetëm falë organizimit vendor politik dhe ushtarak të UÇK-së sot gëzojmë lirinë, të tjerat vijnë pas si mbështetje e kohës. Askush s'do të duhej t'i përdorte shkronjat UÇK apo kohën e lavdisë. Thurja e lëv-

datave apo hetimet mbi atë se çfarë ka ndodhur para 18 vjetësh nuk mund të ndikojë në kualitetin e jetës së qytetarëve tanë, hetimet mbi kohën e lavdisë do të përfundojnë shpejt dhe mirë.

Vazhdimisht sfidohemi nga krimet ekonomike, korrupsioni, nepotizmi dhe mafitë përtej kufijve kombëtarë.

Hapja e rrugës për ndërtim të shtetit të së drejtës duhet t'i eliminojë grupet vendore apo edhe ato ndërkombëtare të natyrës kriminale. Të tilla "shoqëri" kriminale duhet të hetohen dhe të ndalohen. Ne

duhet ta ndërtojmë shtetin e suksesit duke mos justifikuar mospunën dhe dështimet tona me kohët e vjetra si ajo e okupimit, organizimit të luftës apo edhe lëvizjeve politike klandestine.

Unë jam nga ata që kam përkrahur Gjykatën Ndërkombëtare. Ne duhet të mbyllim kapitullin e viteve të kaluara. Jam i sigurt se gjatë kohës së luftës në Kosovë nuk ka krime të kryera që mund të përkufizohen si krime lufte, fjalët dhe propaganda sugjeshive si dhe perceptcionet e krijuara për UÇK-në e di se do të

rrezohen dhe ne edhe individualet, eprorët e UÇK-së, do të dalim faqebardhë.

Pres që Gjykata Speciale ta zgjerojë fushëveprimin e saj dhe të ndiqen krimet ekonomike, të ndiqen ata që në mënyrë të orkestruar kanë keqpërdorur asetet kombëtare, si pronat, ndërmarrjet publike deri te defunksionalizimi i institucioneve vitale në vendin tonë. Mendoj se ka pasur një koordinim të qarqeve "akademike" dhe shoqërore për t'i defunksionalizuar gjithë ato institucione të krijuara me mund si gjykatat, universitetet

dhe gjithçka që i jepte frymë zhvillimit dhe rrugës së vendit për ecje së mbari.

- Implementimi i ligjit
- Lufta kundër korrupsionit
- Gjykata Speciale
- Liberalizimi i vizave
- Armata
- Qasja për ekonomi zhvillimore.

Këto prioritete nuk duhen kushtëzuar mes vete.

Ecja drejt shtetit të suksesshëm do të bëhet. Ata që u takojnë kohëve të lavdisë s'kanë pse të shqetësohen për kohët e arta. Ne duhet ta bëjmë punën që na takon.

## Arsyet e fshehta të Serbisë për 'shkëmbimin e territoreve'



**Milazim KRASNIQI**

Ideja për shkëmbimin e territoreve ndërmjet Serbisë e Kosovës, përkatësisht për "kufizimin ndërmjet serbëve dhe shqiptarëve", sikundër e quan Aleksandër Vuçiqi, është tentativë për ta eliminuar kapitullin 35 në negociatat BE - Serbi dhe Marrëveshjen e Brukselit të 19 prillit 2013. Pse? Sepse me politikën aktuale neofashiste të qeverisë serbe, kapitulli 35 ku është futur normalizimi i marrëdhënieve dhe arritja e një "marrëveshjeje gjithëpërfshirëse" ndërmjet Serbisë dhe Kosovës nuk mund të përmbushet kurrë. Ndërsa në kornizën e negociatave të Bashkimit Evropian me Serbinë, të nëntorit 2014, normalizimi i marrëdhënieve dhe arritja e një marrëveshjeje obligative është shndërruar në normë. Sipas kornizës, nëse ka ngecje në këtë kapitull, atëherë mund të bllokohen edhe kapitujt e tjerë.

Po ashtu, sipas kornizës, Komisioni është i obliguar që dy herë në vit ta njoftojë Këshillin mbi ecurinë në procesin e normalizimit të marrëdhënieve Serbi-Kosovë. Thënë thjesht, kapitulli 35 është pengesë e pakapërcyeshme për Serbinë, me politikën e saj neofashiste që ka ndaj Kosovës. Në periudhën kur Serbia është dashur të ishte e fokusuar në procesin e normalizimit, për të përmbushur kapitullin 35, ajo ka zhvilluar një seri provokacionesh ndaj Kosovës, me murin ndarës në Mitrovicë, me trenin rus, me hyrjet ilegale dhe në kundërshtim me Marrëveshjen e Brukselit të zyrtarëve serbë në territorin e Kosovës dhe me obstrukcionet e Listës Srpska në institucionet e Kosovës. Ditëve të fundit kryeministrja serbe, Ana Bërnabiq, ka kërcënuar edhe me përdorimin e ushtrisë! Në këtë linjë të presionit permanent, presidenti i Serbisë dhe qeveria e tij, kanë zbuluar një shteg për ta anashkaluar disi kapitullin 35, duke e futur në agjendë idenë e shkëmbimit të territoreve, me çka edhe Marrëveshja e Brukselit do të bëhej e pavlefshme. Si duket qeveritarët serbë ose nuk e kanë kuptuar në kohë esencën e Marrëveshjes së Brukselit, ose i

kanë rënë pishman pas nënshkrimit të saj, sepse ajo marrëveshje e përjashton kategorikisht ndarjen e Kosovës dhe e dyta, e pamundëson formimin e asociacionit të komunave serbe me kompetenca ekzekutive. Faktikisht, marrëveshja e Brukselit e ka theksin tek integrimi i komunitetit serb në institucionet e Kosovës (policia, gjyqësia, etj), duke pasur si kompensim formimin e asociacionit të komunave me shumicë serbe, pas verdiktit të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës. Mirëpo, në këtë pikë Serbia ka dalë humbëse ngase mandatin e asociacionit e ka menduar me kompetenca ekzekutive, por meqë e ka pranuar se vlerësimin final të statutit e bën Gjykata Kushtetuese e Kosovës, e ka davanë të humbur. Prandaj kanë kaluar në idenë e shkëmbimit të territoreve, për ta fshehur dështimin lidhur me kompetencat ekzekutive të asociacionit të komunave serbe! Mirëpo, ky ndryshim mbetet në kundërshtim të plotë me Marrëveshjen e Brukselit.

Prandaj qëndrimi hipokrit i Brukselit ndaj pretendimeve të reja serbe, të cilat janë në kundërshtim me Marrëveshjen e Brukselit është i pakuptueshëm. Arsyja e kësaj hipokrizie si

duket sërish është e lidhur me problemin e kapitullit 35 të negociatave BE-Serbi. Edhe Brukseli është bindur se kjo Serbi neofashiste kurrë nuk mund ta përmbush atë kapitull, pasi nuk ka asnjë vullnet, ndaj duan t'ia hapin një deriçkë që Serbia të ecën tutje në rrugën e integritit, pa e pasur si kusht normalizimin e marrëdhënieve me Kosovën. Vetëm kjo taktikë mund ta shpjegojë heqjen dorë të Bashkimit Evropian nga Marrëveshja e Brukselit, të cilën vetë e ka lehtësuar, si dhe nga kapitulli 35 të cilin vetë ia ka imponuar Serbisë.

Në këto lojëra të pista e hipokrite të Beogradit e të Brukselit, institucionet e Kosovës nuk do të duhej të ndihmonin me asgjë. Pra, as me idenë e bashkimit të Luginës së Preshevës, sepse edhe ajo ide është kundër frymës së Marrëveshjes së Brukselit dhe e dyta, ngaqë pashmangshëm do të futej në skemën e pretendimeve serbe për shkëmbim territorësh. Meqë propozimi serb për shkëmbim ose për kufizim ndëretnik ende është në lojë, tash i plotësuar edhe me rebelimin e serbëve në veri të vendit (dorëheqjet e kryetarëve të katër komunave janë pjesë e këtij skenari) institucionet shtetërore të Kosovës

duhet të tregojnë maturi dhe qartësi maksimale. Njëra nga pikat e forta të asaj maturie e qartësie është rrafshimi i termave të Marrëveshjes së Brukselit, e cila e përjashton idenë e ndarjes së Kosovës dhe e thekson riintegrimin e serbëve në institucionet e Kosovës. Në këtë plan, duhet të kërkohet me insistim të madh që Brukseli t'u përmbahet qëndrimeve të mëhershme lidhur me atë marrëveshje e të mos bëjë relativizimin e saj, sepse në atë rast bëhet përgjegjës për eskalimin eventuale të krizës. Bile edhe vonesa dhe jotransparenca e Brukselit lidhur me draftin e statutit të asociacionit të komunave serbe është pjesë e kësaj përgjegjësie. Natyrisht, vonesa e hapjes së Urës së Ibrit është simbol i hipokrizisë së Brukselit. Në këtë frymë, Bashkimit Evropian duhet t'i përkujtohet se është përgjegjës edhe para Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së, e cila me rezolutën A/RES/64/298 të 9 shtatorit 2010 e ka ngarkuar me përgjegjësi për procesin e negociatave ndërmjet Kosovës e Serbisë. Këtë dimension të përgjegjësisë BE-ja si duket sikur e ka harruar, e preokupuar së tepërmi me dobësitë e veta, të cilat po i manifeston keqas edhe në Ballkanin Perëndimor.

(9 dhjetor 2018)

## Asfaltohet rruga 'Richard Holbrooke' në kryeqytet

PRISHTINË, 9 DHJETOR (ER) - Komuna e Prishtinës ka njoftuar se është asfaltuar rruga "Richard Holbrooke" në kryeqytet. Sipas kësaj komune, kjo rrugë do ta lirojë

dukshëm hyrjen e Prishtinës në drejtim të magjistrale së Gjilanit. "Asfaltimi i rrugës 'Richard Holbrooke' do ta lirojë dukshëm trafikun në hyrje të Prishtinës, te magjis-

tralja kah Gjilani. Kjo rrugë është e gjatë 780 metra, me gjerësi në segmentin e parë 10.5 metra, kurse në të dytin 9 metra", ka njoftuar Komuna e Prishtinës.



## Zgjedhjet në PE, socialisti Timmermans përballë demokratit Weber

STRASBURG, 9 DHJETOR - Partitë Evropiane Socialiste (PES) në zgjedhjet e vitit të ardhshëm për Parlamentin Evropian do të udhëhiqen nga Frans Timmermans. Ish-ministri i Jashtëm holandez, që aktualisht është zëvendës-president i Komisionit Evropian, ishte i vetmi person në garë në Kongresin e Socialistëve në Lisbonë dhe do ta sfidojë Manfred Weberin, liderin e Partive Popullore Evropiane në

zgjedhjet e ardhshme. Timmermans foli për disa çështje para mbështetësve të PES, teksa tha se rebelime të dhunshme, si ai që po shihet në Francë, duhet të evitohen dhe për këtë nevojiten politika alternative. "Dhuna nuk është asnjëherë mjet. Dialogu është mënyra më e mirë për të ecur përpara, e ne ofrojmë dialog për të garantuar që do t'i adresojmë çështjet për të cilat populli është i shqetësuar", tha ai.

Duke mbyllur Kongresin, Timmermans tha se zgjedhjet evropiane të vitit të ardhshëm janë kritike për kontinentin. "Zgjedhjet e majit, miqtë e mi, nuk janë të thjeshta. Ato janë zgjedhjet që kanë më shumë në lojë, që nga koha kur zgjedhjet e drejtpërdrejta për Parlamentin Evropian u mbajtën për herë të parë në vitin 1979. Këto zgjedhje kanë të bëjnë me shpirtin e Evropës", deklaroi Timmermans.



## Franca, thirrje Trumpit të mos ndërhyjë në çështje të brendshme

PARIS, 9 DHJETOR - Ministri i Jashtëm i Francës i bëri thirrje presidentit amerikan Donald Trump të dielën, që të mos ndërhyjë në politikën franceze, pas mesazheve të Trumpit në "Twitter" lidhur me protestat në Paris. "Ne nuk merremi me politikën e brendshme amerikane dhe duam të njëjtin gjë në këmbim", tha ministri i Jashtëm, Jean-Yves Le Drian, në televizionin LCI. "Unë dhe presidenti francez i themi Donald Trumpit: mos u merr me vendin tonë", tha ai. Le Drian po reagoonte ndaj mesazheve në "Twitter" të presidentit Trump të dielën, ku ai shkruante se ajo që po ndodhte

në Francë ishte e trishtueshme. "Ndoshta është koha t'i jepet fund marrëveshjes qesharake dhe jashtëzakonisht të shpenzueshme dhe t'u kthehen njerëzve paratë në formën e taksave më të ulëta? Shtetet e Bashkuara e ka bërë këtë me kohë dhe është i vetmi vend ku çlirim i gazeve të dëmshme ra vitin e kaluar", shkruante presidenti. Rreth 2 000 veta u arrestuan të shtunën në gjithë Francën, në raundin e fundit të protestave të "jelekëve të verdhë". Ministria e Brendshme thotë se rreth 136 mijë veta në gjithë vendin protestuan kundër kostos së lartë të jetesës në Francë. Ata



shprehën pakënaqësinë ndaj presidencës së Emmanuel Macronit. Protestat u mbajtën në një numër qytetesh, përveç Parisit, përfshirë

Marsejën, Bordonë, Lionin dhe Tuluzën. Ministria tha të dielën se 1 723 veta u arrestuan në gjithë vendin dhe 1 220 prej tyre janë urdhëruar të mbahen të ndaluar.

Policia parisienne tha se kishte bërë 1 082 arrestime të shtunën, një rritje e madhe krahasuar me 412 të javës së kaluar. Të shtunën ministri i Brendshëm Christophe Castaner tha se shpërthimet e dhunshme në Paris ishin "nën kontroll" pavarësisht prej veprimeve shkatërruese që ai i quajti "krejtësisht të papranueshme". Policia franceze me mbështetjen e auto-blindave përdori gaz lot-sjellës ndaj protestuesve me jelekë të verdhë në Champs Elysees. Castaner tha se numri i demonstruesve në Paris kishte qenë rreth 10 000.

## Samit i shteteve të Gjirit në kohën e tensioneve me Katarin

RIAD, 9 DHJETOR - Grupi i shteteve të Gjirit po mban një takim në kryeqytetin saudit, por Emiri i Katarit nuk pritet që të marrë pjesë në këtë ngjarje, pas rritjes së tensioneve me shtetet e tjera anëtare. Samiti i Këshillit për Bashkëpunim të vendeve të Gjirit - që përbëhet nga Arabia Saudite, Emiratet e Bashkuara Arabe, Bahrejni, Kuvajti, Omani dhe Katar - është mbajtur të



dielën në Riad. Duke cituar një zyrtar të Katarit, agjencia e lajmeve turke "Anadolu" raporton se emiri Tamim bin Hamad Al Thani nuk do të marrë pjesë, por një ministër i Katarit do ta përfaqësojë vendin në këtë ngjarje. Megjithatë, nuk është dhënë asnjë arsye se pse Emiri i Katarit nuk do të marrë pjesë. Ai është ftuar zyrtarisht nga Mbreti Salman i Arabisë Saudite që të

marrë pjesë në këtë ngjarje. Arabia Saudite, Emiratet e Bashkuara Arabe, Bahrejni dhe Egjipti, në qershorin e vitit 2017 ndërprejnë lidhjet diplomatike dhe ekonomike me Katarin, duke e akuzuar këtë shtet se mbështet aktivitetet terroriste në rajon, akuza këto që Katar i mohon. Koalicioni i udhëhequr nga Arabia Saudite ka shprehur shqetësime se Katar ka forcuar lidhjet e tij me Iranin.

## Protestë antiqeveritare në Serbi

BEograd, 9 DHJETOR - Mijëra veta marshuan në Serbi të shtunën kundër atij që po e quajnë "sundim autokratik" të presidentit Aleksandar Vuçiq dhe qeverisë së tij. Vuçiqi, një ish-nacionalist ekstrem, thotë se dëshiron ta reformojë dhe anëtarësojë Serbinë në Bashkimin Evropian, por kritikët e tij thonë se ai po kufizon liritë demokratike dhe medien e vendit. Një aleancë e opozitës organizoi protestën e së shtunës pasi disa

njerëz kohët e fundit rrahën dhe plagosën rëndë kreun e partisë së majtë të Serbisë, Borko Stefanović dhe bashkëpunëtorët e tij në Krushevc. "Ai (presidenti serb Aleksandar Vuçiq) donte që të gjithë ta donin, ta donin në çdo moment. Ai ka blerë nëntë televizorë për të parë veten gjithë ditën. Ai e do veten më shumë sesa njerëzit e tij", tha një nga protestuesit, aktori Branislav Trifunović. Protesta në Beograd u quajti

"Ndalni këmishët e përgjakshme", një referencë për rrahjen e Stefanovićit. Partitë e opozitës kanë fajësuar incidentin në atë që ata e përshkruajnë si një atmosferë dhune dhe kërcënimi të imponuar nga koalicioni qeverisës populist i presidentit Vuçiq. Vuçiqi është një ish-nacionalist ekstrem i cili tani thotë se dëshiron që Serbia të reformohet dhe të anëtarësohet në Bashkimin Evropian.



# Përrurohet në Vjenë romani në gjuhën gjermane '1803' i autorit Besim Xhelili

Shkrimtari nga Tetova, me banim në Vjenë të Austrisë, Besim Xheli, më 7 dhjetor 2018, në ambientet e galerisë së artit "Der Kunstraum" në Vjenë, ka përruar në gjuhën gjermane romanin "1803". Ai tha se është në përgatitje edhe të vëllimit të dytë dhe të tretë të këtij romani, i cili në vitin 2016 u botua së pari në shqip, kurse në janar të këtij viti edhe në gjuhën gjermane dhe suedeze.

## Shkruan: Arben GJINAJ

Në praninë e bashkatdhetarëve të shumtë, përfaqësuesve të Ambasadës së Shqipërisë dhe Ambasadës së Kosovës në Austri, krijuesve dhe dashamirëve të artit të shkruar, në Vjenë të Austrisë u bë përrimi i romanit

"1803" në gjuhën gjermane të autorit Besim Xhelili.

Programin e këtij përrimi e udhëhoqi Kaltrina Durmishi, e cila, ndër të tjera, foli për një pjesë të biografisë së autorit. Hapja u bë me një melodi të bukur në harpë, ekzekutuar nga Veronika Klavzar, dhe fill pas kësaj një shkëputje nga romani e

lexoi Time Durmishi.

I pranishëm ishte edhe përkthyesi i këtij libri, austriaku Kurt Gostentschnigg, i cili u paraqit me një vështrim mbi romanin. Ai shprehu fjalë të zgjedhura për këtë libër dhe sugjeroi lexuesit që ta lexojnë. "Gjatë përkthimit kam gjetur shpeshherë veten në pasazhe të ndryshme në brendi të romanit, ngaqë edhe unë jam njeri dhe kam qenë disa herë i dashuruar. Sugjeroj lexuesit ta lexojnë romanin, të njihen me një ngjarje dashurie, që është më shumë se dashuria vetëm mes dy personave, e të qenurit nën një kulm bashkë, e afërsisë fizike, dhe e cila kalon ndjenjat e dhimbjes, sfidon çastet e vështira të jetës, sepse ajo është një dashuri hyjnore, një pasion që s'përskruhet dot me fjalë, njashtu siç

e thotë edhe vetë autori në paratekstin e romanit", ka thënë Gostentschnigg.

Po ashtu, rreth autorit dhe romanit "1803" foli edhe kryetari i Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Krijuesve Shqiptarë në Austri "Aleksandër Moisiu", Anton Marku. "Libri është paksa mistik dhe flet për një dashuri në distancë. Libri komunikon mirë me lexuesin, është një tematikë moderne, sado qoftë e trilluar dhe fitohet përshtypja se atë nuk e ka shkruar dora e autorit, por vetë shpirti i tij", ka deklaruar Marku.

Të gjithë ishin kureshtarë të kuptojnë se çfarë fshihet pas titullit të librit "1803"?!

Me gjasë autori për këtë do të na shpjegojë në vëllimet e tjera të romanit. "Jam duke punuar për

pjesën e dytë dhe të tretë të librit. Ka disa shenja edhe në pjesën e parë të kësaj trilogjie, ku mund të paramendohet se ç'do të thotë titulli '1803', por qëllimi është që lexuesi vetë të gurmtojë, të argëtohet gjatë leximit, mbase aty-këtu ta gjejë veten dhe të gëzohet me vazhdimin e ngjarjes në dy vëllimet e ardhshme", ka thënë autori nga Tetova me banim në Austri, Besim Xhelili. Programi u përrbyll suksesshëm me pikën muzikore "Margjelo", kënduar nga mezzosoprana Blerta Ismajli, përcjell në piano nga Vlora Jonuzi.

Përrimi i këtij libri është bërë në qytet dhe vende të ndryshme të Evropës. Pronari i galerisë në qendër të Vjenës "Der Kunstraum", Hubert Thurnhofer, vazhdimisht përkrah artistët, krijuesit dhe njerëzit e kulturës, duke lëshuar me një kompensim të vogël objektin e tij tepër artistik dhe tërheqës për artdashësit. Ai, gjithashtu, e përgëzoj autorin Xhelili për romanin dhe i dëshiroi suksese të mëtutjeshme. Vlen të theksohet se botimin e romanit në gjermanisht, me një donacion e kanë përkrahur Ndërmarrja Publike "Wiener Linien" dhe Oda Ekonomike e Vjenës, gjersa përrimin e mbështeti Sektori për Kulturë (MA7) i qytetit të Vjenës. Autori u është mirënjohës dhe falënderues.

Shkrimtari Besim Xhelili, përveç këtij romani, është edhe autor i shtatë vëllimeve me poezi, si dhe është prezantuar në disa antologji në shqip dhe në gjermanisht. Për vitin 2019 ka në proces dy vëllime me poezi në gjuhën shqipe, një në atë gjermane si dhe shpresoj ta mbarojë trilogjinë "1803". Në fund të programit për të pranishmit u shtrua një koktej rasti!



## Flori rrëmben çmimin e parë në 'Kënga Magjike'

TIRANË, 9 DHJETOR (ER) - Këngëtari Flori Mumajesi është shpallur fitues i edicionit të 20-të të "Këngës Magjike" me këngën "Plas". Kjo mbrëmje e së shtunës ka qenë tejet emocionuese në "Pallatin e Kongreseve", ndërkohë që gara mes artistëve të mëdhenj dhe atyre të rinj ka qenë shumë e vështirë.

Çmimin e dytë e morën Aurela Gaçe dhe Eli Fara me këngën "Zemra Rratatata". Ndërkohë Fifi dhe Mc Kresha ishin fitues të çmimit të tretë me këngën "Psikopatia ime". Pasi u shpall

fitues i "Këngës Magjike", Flori u shpreh: "Tani është momenti kur plas vërtet, se më kanë hipur të dridhurat. Gjithë këto vite këtu në këtë festival, me ju në krah. Përfshirja juaj në këtë këngë më ka bërë të lumtur si në ëndërr. Nëse nesër nuk bëj më muzikë, këtë energji e kam ndjerë këtë kohë, pasi e kam shijuar aq bukur sa nuk di ta them. Ju dua juve!"

"Kënga Magjike" për tri ditë në transmetim të drejtpërdrejtë dhuroi te publiku emocione, surpriza dhe humor.



Photo by Olsi Beci

**E rrallë**

## Shtatëvjeçari që fitoi 22 milionë dollarë nga "Youtube"

Ai është një editor në "Youtube" që bën video ku shfaqet duke bërë teste të lodrave për moshatarët e tij. Sigurisht që bota ka shumë fëmijë që pëlqejnë lodra, ndaj ai ka marrë aq shumë klikime sa në vitin 2018 ka mbledhur plot 22 milionë dollarë nga



"Youtube". Një vit më parë kishte fituar 11 milionë dollarë.

## BARSOLETA E DITËS



Mësuesja jep temën e esesë: "Nëse do të ishe drejtor i një ndërmarrjeje...". Të gjithë nisin të shkruajnë, përveç Benit. Pas pak, mësuesja e pyeti:  
- Po ti, pse nuk shkruan?  
- Kjo nuk është puna ime, por e sekretarëshës, mësuese!



### Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

#### "ALPHA" 3D,

Aventure/Drame/Familjar; 1 ore 36 min

Rolet: Kodi Smit-McPhee, Jóhannes Haukur Jóhannesson  
Regjia: Albert Hughes

Vetëm gjatë vikendit në ora 14:00



Në ora 16:00

#### "JOHNNY ENGLISH STRIKES AGAIN"

Aksion/Aventure/Komedi; 1 ore 28 min

Rolet: Rowan Atkinson, Olga Kurylenko, Emma Thompson, Ben Miller, Miranda Hennesy, Jake Lacy, etj.  
Regjia: David Kerr



Në ora 18:00

#### "NIGHT SCHOOL"

Komedi; 1 ore 51 min

Rolet: Kevin Hart, Tiffany Haddish, Rob Riggle, Taran Killam, Romany Malco, etj.  
Regjia: Malcolm D. Lee



Në ora 20:00

#### "SIBERIA",

Komedi; 1 ore 51 min

Rolet: Keanu Reeves, Ana Ularu, Pasha D. Lynchnikoff, James Gracie, Eugene Lipinski, Rafael Petardi, Veronica Ferres, Molly Ringwald, etj.  
Regjia: Matthew Ross



Në ora 22:00

#### "VENOM" 3D,

Aksion/Horror/Fantastiko-Shkencor; 1 ore 52 min

Rolet: Tom Hardy, Michelle Williams, Riz Ahmed, Scott Haze, Reid Scott, etj.  
Regjia: Ruben Fleischer  
Based on the Marvel Comics



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni **FALAS: 0800 22 222** dhe [boxoffice@kinoabc.info](mailto:boxoffice@kinoabc.info), [www.kinoabc.info](http://www.kinoabc.info), fb: **Kino ABC**.

**FOTO E DITES**



Në disa semaforë në Friedberg të Gjermanisë shfaqet drita me figurën e legjendës amerikane të rokut, Elvis Presley. /AP/

**E jashtëzakonshme**

## Një dre i bardhë fotografohet në Norvegji


Disa fotografi të mrekulueshme dhe të rralla janë shkrepur në Norvegji. Një fotograf 24-vjeçar ka fotografuar një dre të bardhë në veri të Norvegjisë,

duke i lënë të gjithë pa fjalë. Dreri është fotografuar nga Mads Nordsveen në veri të Norvegjisë dhe është një krijesë mjaft e veçantë.



 <p><b>DASHI</b> Dita sot do të ndryshojë komplet nga ajo që ju kishit parashikuar. E rëndësishme është të mos ju kapë paniku.</p>	 <p><b>DEMI</b> Po ecni me hapa të avashtë sa iu përket çështjeve të zemrës. Çdo gjë rreth e qark po ju flet për situata të reja.</p>	 <p><b>BINJAKËT</b> Dita do të nisë me një lajm që si fillim mund t'ju çorientojë disi, por që do të jetë mjaft optimist për të ardhmen.</p>	 <p><b>GAFORRJA</b> Keni preferuar të jeni të drejtpërdrejtë me njerëzit sot, por kjo gjë do t'i lëkundë ndjeshëm raportet tuaja me kolegët.</p>	 <p><b>LUANI</b> Sot jeni të pavendosur lidhur me çfarë do të bëni. Kjo gjë vjen për shkak të mosnjohjes se personave që do të keni përballë gjatë ditës.</p>	 <p><b>VIRGJËRESHA</b> Ndonjëherë mund të veproni edhe pa marrë miratimin e të tjerëve. Nëse vendosni të silleni në një mënyrë të caktuar sot, ndajeni mendjen me veten tuaj.</p>
 <p><b>PESHORJA</b> Po vini në provë personat që keni pranë për të parë nëse janë në sintoni me ato që ju mendoni. Sot do të keni një surprizë të këndshme.</p>	 <p><b>AKREPI</b> Ndonjëherë provoni të dëgjoni edhe ata që ju japin këshilla. Jo gjithmonë keni ju të drejtë për gjithçka.</p>	 <p><b>SHIGJETARI</b> Po bëni gjithçka që të mos tregoni shqetësimin që ju ka shkakton një lajm që sapo dëgjuat. Nëse duhet të veproni duhet ta bëni tani.</p>	 <p><b>BRICJAPI</b> Të gjithë do të mundohen t'ju kënaqin sot. Është një ditë e veçantë për ju dhe kjo gjë ju bën të ndiheni të përkëdhelur.</p>	 <p><b>UJORI</b> Po mundoheni t'i modifikoni planet tuaja për të ardhmen sepse keni kuptuar që janë shumë me ambiciozë sesa mundësitë tuaja reale.</p>	 <p><b>PESHQIT</b> Sot mund të ndiheni shumë të kënaqur nga arritjet e projekteve tuaja. Keni ditur se si t'i kombinoni idetë me praktikën në punë.</p>

## Justin Bieber me pjatë rrugëve të qytetit




**K**ëngëtari kanadez, Justin Bieber, është fotografuar duke shëtitur rrugëve të Beverly Hills, njëkohësisht hante edhe ushqim. Bieber u fotografua nga paparacët teksa hante ushqim dhe ecte. Këtë herë ai nuk ishte i shoqëruar nga e gruaja e tij, Hailey Baldwin.

## Era nëse nuk do të bëhej këngëtare, do të zgjedhte të bëhej psikologe



**K**ëngëtarja shqiptare Era Istrefi, e cila tash e sa kohë njihet në botë për suksesin e saj në muzikë, në një intervistë për "Nexus Radio" u pyet se çfarë profesioni do të zgjidhte nëse nuk do të ishte këngëtare. Ajo u përgjigj se profesioni që do të

donte të ishte është psikologe, pasi që i pëlqen të dijë se si funksionon mendja e njeriut. Istrefi gjithashtu foli edhe për arritjet e saj, ku e ceku pjesëmarrjen e saj në Kupën e Botës 2018, duke thënë se për të do të mbetet ndër përvojat më të mira.



## Bebe Rexha akuzohet se nuk e meriton nominimin në "Grammy 2019"

**Ë**shtë hera e parë që këngëtarja me origjinë shqiptare, Bebe Rexha, të nominohet në kategorinë si "Artisti i ri më i mirë" në "Grammy 2019". Ky nominim këngëtares Rexha e gëzoi jashtë mase sa që publikoi

edhe një video në rrjetin e saj social "Instagram" duke qarë. Me këtë nominim nuk pajtohet revista "This is Insider". Sipas saj, Rexha nuk mund të llogaritet më si artiste e re, pasi është në skenë që nga viti 2014.

## Jaden Smith del të bëjë pazar për fundjavë



**A**ktori amerikan Jaden Smith të shtunën doli të bëjë Pazar, pasi ai është në Calabasas për pushime si duket po e shfrytë-

zon në maksimum kohën. 20-vjeçari pati të veshura tuta të zeza të cilat kishim mbishkrime ngjyrë rozë.

# Nëna e Skënderbeut, Vjosava Tribalda ishte e pastër shqiptare, nga Pollogu i Iliridës

Nga Ilmi VELIU\*

Në vitet e tetëdhjeta, për shkak të interesimit tim të madh për të kaluarën shqiptare dhe hulumtimeve për heroizmat e Skënderbeut, nga pushteti i atëhershëm jugosllav u dënova me 4 vjet burg të rëndë të cilin burg e vuajta në Idrizovën famëkeqe të Shkupit.

Ky studim i imi është përgatitur dhe ka të bëjë kryesisht me pretendimet e disa historianëve greko-serbo-sllavë rreth origjinës së Skënderbeut po edhe nënës së tij Voisavës.

Pas një kohe bukur të mirë të hulumtimit, deshifrimet e studimit të dokumentave në Arhivin e Stambollit, arrita që në Universitetin e Shkupit, para komisionit special i formuar vetëm nga historianë maqedonas, studjues të kohës së Skënderbeut, me fakte dhe argumente të shumta dhe në mënyrën më shkencore, ti mbështes për muri dhe të mbroj temën e studimeve posdiplomike me titull: "Skënderbeu në burimet Osmane e Bizantine", ku përfshihet edhe origjina e tij nga nëna po edhe nga babai.

Dokumentat e reja që i zbulova në Arhivin e Stambollit, ku flitet për origjinën shqiptare të Gjergjit po edhe prindërve të tij më ndihmuan që komisioni i formuar me atë rast, i Universitetit të Shkupit, të mbetej pa tekst dhe mos ta hapte gojën.

Nëna e Kastriotit, në shkrimet serbo-sllavo-maqedone, gjithmonë është prezentuar me emrin Voislava (sllave) dhe jo Voisava ose Veisava; e që është emër i sllavizuar. Në latinishten dhe sllavishten e vjetër emri i nënës së Skënderbeut deshifrohet dhe lexohet si Voisava ose Viosava dhe nuk mundet të lexohet si Voislava, sepse te emri origjinal në gjuhën latine po edhe në sllavishten e vjetër nuk është e shenuar shkronja „LL„.

Se emri i nënës së Skënderbeut; Viosava-Voisava-Vjosava nuk mund të lexohet e deshifrohet si Voislava, ( sllave ) kam marrë dhe analizuar edhe përkthimin e Barletit në gjuhën frënge të sh. XVIII ku emri i nënës së Skënderbeut është i përkthyer, deshifruar dhe i shënuar si Veisava dhe jo Voislava.

Ja burimet që flasin për origjinën e nënës së Skënderbeut e që historianët e politizuar nuk duan ti marrin parasyshë.

1.Gjon Muzaka, bashkëkohas i Skënderbeut dhe njohës i mirë i aristocracisë shqiptare të asaj kohe, në "Gjenealogjinë" e tij në tre vende e përmend nënën e Gjergj Kastriotit-Voisavën, por ai duke e ditur dhe duke qenë i sigurt se ajo dhe babai i sajë vinin nga një trevë pastër shqiptare „Pollogu i Dardanisë„, dhe se ata gjithëqysh

ishën me origjinë shqiptare, nuk e ka parë të arsyeshme që të flasë edhe për origjinën apo prejardhjen e tyre etnike.

Muzaka shkruan se Gjon Kastrioti me Voisava Tibaldën kishte katër djem dhe pesë vajza. Pastaj më poshtë shënon se nëna e Skënderbeut dhe gruaja e Gjon Kastriotit quhej Voisava Tribalda. Gjon Muzaka flet për Voisavën edhe në pjesën ku thotë se Skënderbeu rrjedh nga prindërit Voisava dhe Gjoni, e që Voisava ishte bijë nga një familje aristokrate dhe shumë e respektuar e Pollogut - familja Tribalda.

Muzaka, asnjëherë dhe në asnjë vënd në shkrimin e tij nuk e ve në dyshim origjinën shqiptare të Voisavës sepse ai e ka ditur dhe e ka pasur të kuartë se Pollogu në kohën e Bardhylit, Agronit e Tetutës ka qenë pjesë e Dardanisë ilire, e që gjithmonë ka qenë i banuar nga iliro-arbërit, e edhe gjatë periudhës bizantine, osmane, të Car Dushanit, po edhe sot, vazhdon të jetë 99% i banuar nga shqiptarët.

-Fan S. Noli, në veprën e tij për Kastriotin thote se Gjon Muzaka është autori i parë që e ka përmendur mbiemrin e nënës së Skënderbeut-Tribalda. Pra Muzaka i pari na ka informuar se mbiemri i vajzërisë së Voisavës ka qenë Tribalda e që ka qenë edhe mbiemër i babait të sajë Gërgurit, princit të principatës së Pollogut.

-Kristo Frasheri, historiani jonë shumë i famshëm, thote se përkatësia etnike shqiptare e Voisavës ka qenë mirë e ditur dhe mirë e njohur, jo vetëm prej Gjon Muzakës por edhe nga të gjithë bashkëkohësit e Muzakes, të trashgimetarëve të tyre, po edhe rrethit miqësorë më të gjerë që e kan rrethuar familjen e princit të Pollogut, Gërgur Tribalda.

2.Marin Barleti, 1508, është autor e biograf i jetës së Skënderbeut dhe duke informuar për prindërit e Gjergjit, thotë se nëna e tij quhej Voisava, që ishte e bia e njërit ndër princërit më të njohur të familjes Tribalda te Principatës së Pollogut e që ka qenë princ dhe sundimtar i kesajë krahine shqiptare deri në kohën kur i gjithë Ballkani pushtohet nga osmanët. Barleti duke e ditur dhe duke e pasur të kuartë se krahina e Pollogut i ka takuar Dardanisë ilire dhe se e gjithë Dardania ka qenë shqiptare që nga koha ilire, pastaj ka vazhduar si krahinë shqiptare edhe në kohët që i përmendëm më lartë, nuk e ka parë të arsyeshme që të merret me përkatësinë dhe origjinën e sajë kombëtare ose te bente pyetje se cilës përkatësie etnike i takonte trunngu i sajë familjarë.

3.Autori bullgar, Ivan Ivanov në veprën e tij „Bllgarski Starini„, 1990 Sofija, thotë se pas vrasjes së princit Vukashin nga osmanët, më 1371 te Beteja e lumi Marica, me pjesën e Maqedonisë së sotme lin-



dore (Strumica, Kavadari, Gjevgjelia, Shtipi) vazhdon të sundojë djali i tij, Krali Marko, kurse me pjesën që sot i thonë Maqedonia Perëndimore vazhdon të sundojë princi i Pollogut me emrin Gërguri, i cili bëhet sundimtar i pollogut pas shkatërrimit të perandorisë serbe dhe dobësimit të asajë Bizantine.

Nga këto të dhëna del se babai i Voisavës-Gërguri udhëhiqte me principatën e Pollogut shumë më herët se sa këto troje të bienin nën sundimin Osman dhe mund të supozohet se Pollogu qe pushtuar shpejt pas pushtimit të Shkupit më 1392, koha kur në dokumente, si zotëri i Pollogut përmendet pikërisht Gërguri dhe kufiri i shtetit të tij në veriperëndim të Pollogut.

Bashkë me princat tjerë serbë të Ballkanit, Vuk Branković e Krali Marko, po edhe princat e fuqizuar shqiptarë të familjeve bujare shqiptare të asajë kohe, Thopia, Skurra, Muzaka, Arianiti, Ballsha, Kastrioti; edhe princi i Pollogut-Gërguri, pranon që përkohësisht të bëhej vasal i Sulltanit me qëllim që të mbetej sundimtar i principatës shqiptare të Pollogut.

Për ta vërtetuar atë që thamë më lartë duhet të shkarojmë edhe njëherë se pas vdekjes së Car Dushanit dhe shkatërrimit të perandorisë serbe, feudalët shqiptarë që i përmendëm më lartë me një shpejtësi të madhe fillojnë të ngriten dhe fuqizohen me principatat e tyre, kohë kjo kur edhe babai i Voisavës-Gërguri ka qenë një nga ata feudal shqiptarë që behet i fuqishëm dhe sundon me Pollogun deri në vitin 1392, kur Pollogu sëbashku me Shkupin bien nën sundimin Osman.

4.Boban Petreski, profesor i Universitetit te Shkupit, në shkrimet e tia citon të ketë hulumtuar dhe analizuar autorë si: Ivan Ivanov „Bëlgarski starini od Makedonija„; Mihajlo Diniq, „Oblast Brankoviqa„; Milan Shuica, „O Cezaru Gerguru„, ku ka gjetur dhe vërtetuar se Tribalda është mbiemër personal i Voisavës,

babait të sajë Gërgurit dhe familjes së tyre më të gjerë dhe nuk ka të bëjë me fisin e Tribalëve, i cili fis asnjëherë nuk është shtrirë në Dardanië ilire ku sot shtrihet krahina e Pollogut.

Petreski, me argumentet që prezenton, ka arritur ta shkëpusë në mënyrë të suksesshme lidhjen e Voisavës dhe babait të sajë Gërgurit me fisin e vjetër të Tribalëve, i cili zbulim është më shumë në shërbim të shqiptarëve dhe nuk i ndihmon serbët, grekët e maqedonët që ta lidhin origjinën e Voisavës e Gërgurit me sllavët.

Dokumenti i dytë që bie Petreski është ai se ajo ka qenë e bia e Gërgurit, mbretit të Pollogut, i cili pohim është plotësisht i pranueshëm për ne shqiptarët sepse ekzistojnë dokumente shumë të fuqishme, se me të vërtetë në kohën për të cilën na flasim, mbret i Pollogut ka qenë Gërguri, por emri Gërgur është shqiptarë, edhe sot përdoret në Kosovë si mbiemër e emër fisi dhe asnjëherë nuk është përdorur e as sot nuk përdoret nga sllavët.

Në lindje të Pollogut ekziston fshati shqiptar me emrin „Gërgurnica„, që është emri i princit shqiptar „Gërguri.....ku ka qenë qendra apo këshjtjella e principatës së tij. Njohuritë e këtilla që ne i marrim nga informatat e burimeve të dhëna, ku shënohet se babai i Voisavës ishte mbret apo princ i principatës së Pollogut, del se ai udhëhiqte me Pollogun deri në kohën kur këtu arritën osmanët.

Nga te dhenat vërtetohet se krahina e Pollogut nuk ra nën turqit pas betejës te lumi Marica më 1371, betejës te Fusha e Savrës më 1385 në Shqipëri, e as pas betejës në Fushë Kosovë më 1389. Krahina e Pollogut, territor ky që shtrihet nga vëndi i quajtur „Karpallak„, afër Shkupit e Zhelinës, në veri të Pollogut e deri te maja e malit Bukočë në mes të Kërçovës e Gostivarit, në jug. Ky territor pra, bie nën osmanët menjëherë pas marrjes së Shkupit më 1392, koha kur edhe në dokumentet osmane si zotëri i Pollogut përmendet të ketë qenë princi me emrin Gërguri,

e që del të jetë babai i vajzës së vetme me emrin Voisava.

Dokument shumë i vlefshëm që e përmend Voisavën si e bia e mbretit të Pollogut, me emrin Gërguri, është edhe një letër e shkruar nga eremonahu Mihali nga Manastiri Leshka, në Pollog, e që është i shkruar në sllavishten e vjetër në vitin 1366. Ky manastir vazhdon të ekzistoi edhe sot me te nejtin emër në veri të Tetovës. Në dokument thuhet se „Prifti Mihon i fshatit „Debrishtë„, të Pollogut na ka lënë një shënim për Voisavën, të binë e mbretit të Pollogut, me emrin Gërguri, se ajo i ka dhuruar Manastirit „Leshka„, një mal të madh me lisa„. (Stari srpski zapisi, L. Stojanović, Beograd, 1982) Sado që të kërkojnë e hulumtojnë ata që shkruajnë e flasin kot për origjinën jo shqiptare të Voisava Tribalda, nuk do të mund të hasin ndonjë grek apo familje sllave në Ballkan me emrin Gërgur. Përkundrazi në Kosovë e hasim edhe sot si emër fisi apo familje shqiptare, Gërguri, te Gërgurët, si që janë Krasniq, Berisha, Thaqi, Kelmend etj.

*Sipas hulumtimeve që kam berë dhe dokumentave që kam gjetur në Arhivin e Stambollit, analizuar e krahasuar me dokumentat e deritashme, del se Skënderbeu (Gjergji) ka qenë i Gjonit dhe Gjoni i Gjergjit të parë, dmth se Skënderbeu ka pasur emrin e gjyshit të tij. Në kohën kur babai i Skënderbeut- Gjoni e trashëgon dhe zavendëson babain e tij, dhe vjen në krye të principatës së Kastriotëve, i gjen kufijtë dhe territorin e principatës së Kastriotëve shumë të zgjëruar. Kësajë principate i ka takuar edhe territori i dy Dibrave po edhe territore të tjera jashta Dibrave. Pikërisht në këtë kohë, dmth. fundi i sh. XIV, Gjoni marrohet me Voisavën, që ka qenë fëmiju i vetëm i princit të Pollogut-Gërgurit, e që bashkë me nusen nga Pollogu, Gjoni trashigon edhe principatën e Pollogut.*

\*Historian dhe ekspert i periudhës së Kastriotit

“Marrë nga gazeta” Tema”



# Kongoli: Leximi dikur një mënyrë ekzistence, sot është kthyer në luks



Shkrimtari dhe akademiku Fatos Kongoli takon lexuesit dhe dashamirësit në stendën e librave. Në një kohë kur leximi është në krizë, letërsia e tij bashkon tre breza. Kongoli rrëfen autorët që ndikuan tek ai, letërsinë e socrealizmit dhe dy fjalë për politikanët e palexuar.

Janë të shumtë ata që janë shprehur se ethet e Panairit të Librit nuk janë ato të dikurshmet... Si vjen ky edicioni i 21-të në sytë e një prej emrave më të mirë të letërsisë shqipe, por edhe një lexuesi të kualifikuar? Unë nuk e ndiej diçka të tillë. Sa herë që vij në Panair qëndroj me shumë kënaqësi në stendë. Kam vazhdimisht kontakt me lexuesit. Kjo është diçka tepër e bukur për mua. Librat e mi po kërkohen dhe tërhiqen, kështu që në këtë drejtim jam shumë i kënaqur. Pastaj ecurinë e Panairit në tërësi e dinë më mirë organizatorët, të cilët mbajnë statistika. Mendimi i përgjithshëm është që leximi ka rënë dhe kjo duhet të jetë e vërtetë, mirëpo nuk është thjesht një fenomen shqiptar, është një dukuri botërore.

Lexuesit juve ua shprehën kërshërinë dhe dëshirën e tyre për libra të rinj... (Ishin të shumtë ata që i rrëfenin se po prisnin me padurim librin e ri prej shkrimtarit). Unë këtë e konsideroj si një

kompliment të madh që më bëhet. Sigurisht që kënaqem shumë! Në fund të fundit një shkrimtar ka shumë pak çaste kënaqësie të vërtetë në jetë, sepse të krijosh është një mundim. Por, kur lexuesi të vlerëson dhe njerëz, të cilët nuk i njeh të thonë: "Më pëlqejnë librat e tu", sigurisht që është një përkëdhelje në sedër.

**Po diskutohet më gjerësisht për distancimin e lexuesit nga libri. Sipas jush, çfarë ka bërë që të ndodhë një dukuri e tillë?**

Ka shumë arsye. Një ndër to është, se ka fusha të tjera informacioni ku njerëzit komunikojnë. Sepse, libri çfarë është?! Një lloj komunikimi, kulturë... Sot janë rrjetet sociale, interneti, që mesa duket ndikojnë në rënien e leximit. Por siç jua thashë është një dukuri botërore, jo thjesht shqiptare.

**Një lexuesi të ri që do të shfletojë librat tuaj, cili do të ishte titulli që do t'i sugjeronit?**

Kjo varet se çfarë lexuesi është, cila është moshë e tij... Do të

sugjeroja çdo libër timin!

**A keni një, që e keni më shumë për zemër?**

Të gjithë librat e mi janë shitur, janë tërhequr, botohen e ribotohen. Por unë mund të them se dy librat e mi më të suksesshëm janë romanet "I humburi" dhe "Lëkura e qenit". Janë dy romane që kanë njohur botime të shumta dhe në gjuhë të huaj. Sigurisht që ka pasur edhe libra të tjerë të botuar jashtë, por këta dy libra, sipas meje mbajnë rekord.

**Lexoni autorë të rinj?**

Kam pas lexuar, por ka nga dy vjet që për arsye shëndetësore nuk shkruaj as vetë, kështu që lexoj pak.

**Me aq sa keni mundur të shfletoni, sipas jush, a po "prodhon" Shqipëria autorë të mirë?**

Mesa shikoj ka... Është e pamundur të mos ketë!

**Cilët janë autorët e huaj që kanë ndikuar tek ju në fillimet tuaja?**

Janë dy autorët e letërsisë botërore, prej të cilëve jam ndikuar dhe që i dua shumë. Bëhet fjalë për dy klasikët e mëdhenj, Fjodor Dostojevskin dhe Albert Kamy.

**Kohët e fundit ka pasur disku-**

**time edhe rreth letërsisë që është shkruar në periudhën e komunizmit. Është propozuar, që librat e realizmit socialist, të cilët i kanë shërbyer atij sistemi, të shoqërohen me një shënim. Ç'mendonit ju rreth kësaj iniciative?**

Unë mendoj se lexuesi i çdo kohe është mjaft inteligjent për të zgjedhur çfarë duhet lexuar dhe çfarë jo. Pra për të mos krijuar keqkuptime unë them t'ja lëmë lexuesit, që ai vetë të zgjedhë atë që ç'ka dëshiron.

**E megjithatë gjatë sistemit totalitar edhe pse ka pasur kufizime, është prodhuar letërsi cilësore. Përpos kësaj ka pasur edhe lexues më të përkushtuar...**

Unë mund të them se disa nga shkrimtarët tanë në atë kohë kanë krijuar kryeveprat e tyre. Leximi ishte shumë i përhapur, sepse e tillë ishte jeta. Në një mjedis të mbyllur lexohej shumë, veçanërisht në qendrat e mëdha, ku ndërtoheshin vepra industriale etj. Lexohej mjaft.

**Ju asokohe keni lexuar libra "të ndaluar"?**

Sigurisht! Ka qenë një periudhë, në të cilën leximi ishte një mënyrë ekzistence, kurse tani, sipas meje, leximi është kthyer në luks për shumë arsye.

Mirëpo dua të theksoj se të lexuarit është gjëja më e mrekulueshme dhe më e vlefshme për çdo individ.

**Leximi dhe politikanët tanë duket gjithashtu se qëndrojnë të distancuar... Ç'mendonit rreth kësaj?**

Politikanët jetojnë në një galaktikë më vete...

**E megjithatë Shqipëria ka nevojë për politikanë të lexuar...**

Patjetër. Letërsia i shërben edhe përkorjes, rafinimit të ndjenjave e të mendimeve, përpunon njeriun. Unë në fakt jam i distancua nga politika, por mendoj se një njeri që nuk lexon ka një defekt shumë të madh. Kjo vlen sidomos për njerëzit që merren me fatet e njerëzve, të vendeve, të cilët jetojnë në një botë të mbyllur dhe kjo është një gjë shumë e keqe.

**Po ju vizitojnë në stendë edhe autorë të rinj, të cilët përpos talentit kanë nevojë edhe për një sugjerim, që do t'i ndihmonte për t'u bërë një shkrimtar i mirë. Çfarë do tu këshillonit?**

Punë, punë dhe vetëm punë! Pa talent nuk bëhet, por talenti është baras me punën. Ai që punon do të thotë se ka talent.

/Shekulli/



# Natalia Kircheva, mësuesja e gjuhës dhe traditave shqiptare në Ukrainë



Natalia Kircheva është mësuese e gjuhës shqipe në shkollën e fshatit Karakurt në lagjen Bolgard të Odessa, Ukrainë, ku shqiptarët dhe banorët e tjerë të pakicave të ndryshme jetojnë në mënyrë kompakte.

Ministri i Shtetit për Diasporën, Pandeli Majko, shprehet se "Natalia Kircheva është mësuesja e parë e gjuhës shqipe në Karakurt, fshatin në Ukrainë ku jetojnë shqiptarë. Pasi përfundoi studimet në Universitetin e Tiranës ajo u kthye në vendin e saj për t'u mësuar fëmijëve jo vetëm

gjuhën shqipe, por edhe historinë dhe traditat shqiptare". Në vitin 2015 ajo u bë studentja e parë në Universitetin e Tiranës, Shqipëri. Sot ajo jep lëndën zgjedhore të gjuhës shqipe për nxënësit e formës së pestë në shkollën Karakurt. Programi është bërë së bashku me Institutin e teknologjive të

reja të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës të Ukrainës.

Fëmijët jo vetëm që mësojnë gjuhën shqipe të shkruar, zhvillojnë aftësitë gjuhësore, por mësojnë historinë dhe traditat shqiptare, shkruan ata.

Para Kirchevas, askush nuk jepte mësim të tilla në Ukrainë, prandaj me praktikë, sipas Natalias, programi do të ndryshojë dhe përmirësohet.

Natalia është jo vetëm një mësuese, por edhe një patriotë e madhe e tokës së saj, shtëpisë stërgjyshore – Shqipërisë dhe çështjes së jetës së saj. /kultplus/



## KDI me ekspozitë kundër korrupsionit, kërkohen shkarkime për zyrtarë të korruptuar



Në kuadër të Ditës Ndërkombëtare Kundër Korrupsionit Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) ka organizuar ekspozitën e fotografive dhe ceremoninë e ndarjes së çmimeve për tri vendet e para në garën e fotografive dhe videove #fajikorrupsionit.

Këto gara janë zhvilluar në kuadër të aktiviteteve të KDI-së pikërisht në javën e korrupsionit në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve të Jashtme të Gjermanisë. Ana Becki nga ambasada e Gjermanisë në Kosovë tha se, shpresojnë që kjo javë të jetë javë ndërgjegjësuese për qytetarët e Kosovës. "Korrupsioni dëmton jetën tonë. Në gëzon fakti që

qytetarët kanë marrë pjesë në numër kaq të madh për këtë ditë. Shpresoj që kjo do jetë dita e ndërgjegjes", tha ajo, raporton Ekonomia Online. Shaip Havolli drejtor në Agjencionin Kundër Korrupsionit tha se niveli i korrupsionit në Kosovë është mjaftë i lartë. "Sa i përket kësaj jave flasin fotografitë e ekspozuara sot. Niveli i korrup-

sionit është i lartë dhe jemi të mobilizuar ta luftojmë atë", tha ai.

Florent Spahija zyrtarë ligjor në KDI tha se Kosova ka një qeveri të korrumpuar derisa deklaroi se KDI kërkon dorëheqjen dhe hetim të kryeprokurorit Aleksandër Lumezi. "Sot jemi mbledhur për ta shpallur fituesin e foto-garës dhe video-garës. Këto aktivitete kanë ndikim në luftën kundër korrupsionit.

Kosova rradhitet në vendin 85 me 39 pikë. Vazhdojmë që ende të kemi një qeveri të korrumpuar. Duke e pasur parasysh edhe numrin e madh të zministrave. Duhet që numri i qeveritarëve të zvogëlohet. Po ashtu kërkohet edhe dorëheqjen e prokurorit Lumëzi", tha ai, raporton EO.

E në fund u ndanë edhe çmimet për fotografinë dhe videon më të mirë në kuadër të javës kundër korrupsionit. Vendet e 3-ta ju takuan Altin Gashi dhe Basri Oruçaj, vendet e dyta i takuan Milot Krasniqi dhe Florent Kastratit, ndërsa vendi parë i takoi Bardha Bogës dhe Agon Nimanit.



**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Enveri  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE**  
"BUJQËSIA"  
TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE

EVERTON - WATFORD

1

ATHLETIC BILBAO - GIRONA

GG

VFL BOCHUM - ST PAULI

1

# Prishtina dhe Feronikeli, pa problem në çerekfinale, eliminohet Besa

Prishtina, Feronikeli, Trepça '89, Drita, Ballkani, Ferizaj, Vëllaznimi dhe Kika kanë arritur sukses duke u kualifikuar në çerekfinale të Digitalb Kupës së Kosovës në futboll. Tërheqja e shortit bëhet më 11 dhjetor nga ora 13:00

**EPOKA E RE** Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 9 DHJETOR - Tetë skuadra kanë siguruar kualifikimin në çerekfinale të Kupës së Kosovës në futboll. Të dielën skuadra e Feronikelit e ka deklasuar Dukagjinin e Klinës, duke e mposhtur me rezultat 0-4 dhe në këtë mënyrë skuadra nga Drenasi do ta vazhdojë garën për trofeun që e dërgon skuadrën fituese në Ligën e Evropës, kurse Dukagjini do të bëjë përpjekje për t'u inkuadruar në elitë. Golat për skuadrën e Feronikelit i shënuan Astrit Fazliu (46'), Albutrint Morina (53'), Kastriot Rexha (57') dhe Artur Magani (84').

Të dielën kualifikimin në garën e Kupës e siguroi edhe skuadra e Ballkanit e cila në Suharekë e mposhti Gjilanin (3-0). Blend Baftiu realizoi dy gola, kurse një tjetër e shënoi kapiteni Visar Berisha. Trepça '89 e mposhti në vazhdimë skuadrën e Flamurtarit (3-0), ndërsa skuadra e Kikës e eliminoi skuadrën e Istogut pas penalltive me rezultat 3-1. Koha e rregullt dhe vazhdimet kishin përfunduar me rezultat 2-2. Të shtunën skuadra



kampione e vjeshtës dhe fituesja në fuqi e Kupës, Prishtina, ishte skuadër bindëse ndaj Lirisë. Kryeqytetasit shënuan fitore me rezultat bindës 0-4, kurse në këtë ndeshje dy gola i realizoi Basid Khalid dhe nga një tjetër e shtuan Meriton Korenica dhe Ergyn Ahmeti.

Të shtunën skuadra e Besës u eliminua nga rivali nga Rrafshi i Dukagjinit, Vëllaznimi i Gjakovës. Kuqezinjtë fituan në penallti me rezultat 3-2. Tërheqja e shortit për çerekfinale të Digitalb Kupës së Kosovës do të bëhet të martën, më 11 dhjetor, në orën 13:00, në selinë e FFK-së.

REZULTATET	
Dukagjini - Feronikeli	0-4
Trepça '89 - Flamurtari	0-0
(Pas vazhdimëve 3-0)	
Kika - Istogu	2-2
(Pas penalltive)	3-1
Liria - Prishtina	0-4
Fushë-Kosova - Ferizaj	1-2
Drita - Minatori	5-3
Besa - Vëllaznimi	0-0
(Pas penalltive 2-3)	
Ballkani - Gjilani	3-0

## SHKURT

### Ferit Keta, për herë të parë kampion bote në kikboks

Ferit Keta u shpall për herë të parë kampion bote në kikboks, pasi mundi turkun Fatih Karakus në Mynih. Më 8 shtator ai fitoi në eventin e Dibrës së Madhe në boks dhe kundërshtari shfrytëzoi mediet dhe rrjetet sociale, duke i kërkuar revansh dhe vuri në ring titullin që mbante si kampion bote. Ferit Keta, që stërvitet nga trajneri i mirënjohur Ismail Keta, fitoi bindshëm duke arritur ta mposhtë rivalin e tij dhe të fitojë një titull Evrope. Kjo ishte ndeshja e 19 në kikboks për Ketën dhe të gjitha i ka fituar, ndërsa në boks ka 11 ndeshje dhe asnjë humbje.

### Ajeti shënon në derbin e shqiptarëve në Zvicër

Sulmuesi i Baselit, Alban Ajeti, ka realizuar gol për skuadrën e tij në ndeshjen ndaj Zurichut, në "derbin e shqiptarëve" në Zvicër. Reprezentuesi i Zvicrës shënoi në minutën e 19 për ta kaluar Baselin në epërsi 1-0, kurse këtë ndeshje skuadra e Ajetit e fitoi me rezultat 2-0. Për Zurichun u paraqitën Benjamin Kolli, Hekuran Kryeziu dhe Mirlind Kryeziu.

### Fitojnë Vushtrria, Besa dhe Prishtina

Vushtrria ka shkaktuar befasi të madhe në javën e 13-të të Superligës së Kosovës në hendboll (meshkujt). Kjo skuadër e mposhti Dritën e Gjilanit me rezultat 30:29. Shabanaj me 10 gola ishte më efikas te Vushtrria, kurse 8 gola i shënoi Musa. Te Drita nga 9 gola i shënuan Misini e Cimili. Vushtrria tani i ka 11 pikë në vend të pestë, kurse Drita mbetet e katërta me 18 pikë. Besa Famgas fitoi ndaj Zhegrës në Pejë me rezultat 41:13, ndërsa Prishtina e mposhti Drenicën në Drenas me rezultat 46:23.

### Rahoveci fiton me përmbysje ndaj Ponte Prizrenit

Skuadra e Rahovecit është rikthyer nga disavantazhi i lartë në pjesën e dytë të sfidës si mysafir i Ponte Prizrenit, për ta fituar ndeshjen (73-66). Vendësit e nisën mirë sfidën duke shënuar 12 pikë më shumë se kundërshtari në çerekun e parë (22-10). Edhe në dhjetëminutëshin e dytë nikoqirët luajtën më mirë (21-17) dhe shkuan në pushim me avantazh bindës (43-27). Rikthimi i mysafirëve ndodhi në çerekun e tretë në të cilin shënuan 27 pikë kundrejt dhjetë pikëve të pranuar. Edhe në fraksionin e fundit (13-19) "vreshtarët" u angazhuan shumë për ta fituar sfidën me rezultat 73-66. Kjo ishte fitorja e tetë e Rahovecit këtë sezon, në të cilin ka regjistruar edhe katër humbje dhe numëron 20 pikë në vend të dytë në tabelë (aq sa ka edhe Z Mobile Prishtina në krye, me dy ndeshje më pak të zhvilluara). Ponte Prizreni është në vend të shtatë me katër fitore dhe shtatë humbje të regjistruara, në 11 ndeshje të zhvilluara.

## Drejtuesit e FFK-së bënë homazhe te varri i Fadil Vokrrit

PRISHTINË, 9 DHJETOR - Kryetari i Federatës së Futbollit të Kosovës, Agim Ademi dhe drejtuesit e tjerë të FFK-së, kanë bërë homazhe te varri i presidentit të ndjerë, Fadil

Vokrrit. Të pranishëm ishin edhe bashkëpunëtorë dhe familjarë të ish-presidentit, pastaj drejtuesit dhe futbollistët e KF 'Llapi', drejtuesit e grupit të tifozëve 'Dardanët'

dhe dashamirë të ish-presidentit Vokrrit. Legjenda e futbollit të Kosovës dhe kryetari historik i Federatës së Futbollit të Kosovës, Fadil Vokrrit, ka ndërruar jetë para

gjashtë muajsh, pas një sulmi në zemër. Emrin e Fadil Vokrrit tash e mban stadiumi i qytetit në Prishtinë, i cili filloi riparimin e tërësishëm me iniciativën e Vokrrit.



## Malisheva bëhet me stadium, vitin e ardhshëm edhe me pishinë gjysmolimpike

Malishevë, 9 dhjetor - Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, bashkë me kryetarin e Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, ka bërë përrurimin e stadiumit të Malishevës. "Është moment i veçantë për mua, për Qeverinë e Republikës së

Kosovës, edhe për Komunën e Malishevës dhe qytetarët e saj, që më në fund po e realizojmë një ëndërr të kamotshme të të gjithë sportistëve e sportdashësve, që edhe Malisheva ta ketë infrastrukturën e nevojshme për zhvillimin e aktiviteteve sportive,

përkatësisht realizimin e sportit të futbollit", ka thënë Gashi, duke shtuar: "Ministria e Sportit vitin e ardhshëm do t'i fillojë punimet për ndërtimin e pishinës gjysmolimpike në Komunën e Malishevës, marr për shkas që kjo komunë nji-

het për traditën që ka në këtë lëmë sportiv". Ndërsa kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, e falënderoi ministrin Gashi për bashkëpunimin e ngushtë dhe ndihmën që ofron për Komunën e Malishevës.



## Lakersat triumfojnë ndaj Memphisit, zhgënjejnë Houstoni dhe Clippersat

MEMPHIS, 9 DHJETOR - Lakersat rikthehen te fitorja në NBA, pas triumfit 111-88 në fushën e Memphisit, ndeshje e komanduar nga kalifornianët, që arritën një fitore të rëndësishme për renditje në Konferencën e Perëndimit. James e Kuzma realizuan nga 20 pikë secili për Lakersin, ndërkohë që gjashtë lojtarë të ekipit kalifornian shënuan mbi 10 pikë. Vijon momenti i keq i Houstonit, që nga pretendent për titull, renditet në vendin e parafundit në Perëndim. Ekipi teksan u mund sot 107-104 nga Dallasi, një sfidë emocionuese dhe me rivalitet deri në fund, ku të dyja skuadrat e kërkuan fitoren. Matthews dhe Donçiqi realizuan nga 21 pikë për Dallasin, por kolektiviteti ishte çelësi i fitores, ndërsa për Houstonin nuk mjaftuan 35 pikë e Hardenit për ta evituar humbjen.

Surprizë disfata që ekipi i Clippersit pësoi në fushën e tij, ku u mund 121-98 nga Miami, një ndeshje ku pritej fitorja e skuadrës kaliforniane, por që zhgënjeu në periodën e katërt, e cila vendosi edhe fatin e sfidës. Wade rikthehet protagonist, duke realizuar 24 pikë për ekipin nga Florida, edhe pse e nisi ndeshjen nga stoli,



mbështetur edhe nga Winsslow me 21 pikë, raporton "Telesport". Fitore të lehtë arriti edhe skuadra e Bostonit, që mundi 133-77 Chicagon, sfidë ku për Celticsin u dalluan Brown me 23 pikë e Theisi me 22 pikë e 10 rebounde (62 pikë erdhën nga lojtarët e stolit). Suksesi i gjashtë sezonal për nënkampionët e Clevelandit, që mundën 116-101 Washingtonin (Sexton 29 pikë), ndërsa Brooklyn triumfoi 112-104 ndaj New Yorkut në derbi,

sfidë ku diferencën e bëri Dinwiddie me 25 pikë.

### REZULTATET

Dallas - Houston	107-104
Indiana - Sacramento	107-97
Atlanta - Denver	106-98
Cleveland - Washington	116-101
New York - Brooklyn	104-112
Chicago - Boston	77-133
Memphis - Lakers	88-111
Portland - Minnesota	113-105
Clippers - Miami	98-121

## Ibra: Perezi ka rivalizuar me Messin, jo Ronaldo

MADRID, 9 DHJETOR - Luka Modriq u shpall fitues i "Topit të Artë" për këtë vit. Një vendim i tillë u mirëprit nga shumë tifozë, po ka dhe të tjerë që mendojnë ndryshe. Është edhe dikush tjetër që nuk bën pjesë në asnjërën palë: Zlatan Ibrahimović. Gjiganti suedez ka dhënë një përgjigje të shkurtër për "Fox Sports Asia" dhe diçka e tillë do të shkaktojë polemika. Sulmuesi i Los Angeles Galaxy ka bërë të qartë ndikimin e fortë të Realit të Madridit në çmimin prestigjioz. "Tani e kemi të qartë që ka qenë Florentino Perez ai i cili ka rivalizuar me Leo Messin për 'Topin e Artë', jo Cristiano Ronaldo", ka komentuar Ibrahimović, i cili nuk ngurron t'i qajë si vendime "politike"



dhe pesë "Topat e Artë" të fituar nga Cristiano Ronaldo, po aq sa ka edhe Leo Messi. Mes të dyve

nuk ka pasur kurrë simpati, por Ibra nuk ka as për Luka Modriqin.

### SHKURT

#### Chelsea, 22 milionë për Hysajn

Skuadra e Chelseat ka bërë ofertë prej 22 milionë eurosh për mbrojtësin shqiptar, Elseid Hysajn, raporton "The Sun". Trajneri i Chelseat, Maurizio Sarri, kishte punuar me Hysajn te Napoli dhe e dëshiron transferimin e tij në "Stamford Bridge". Chelsea kishte tentuar ta transferonte Hysajn edhe në afatin kalimtar të verës, por ishte Napoli që kishte bllokuar largimin e tij. Kurse klubi anglez synon ta transferojë atë në janar.

#### Kane shihet si zëvendësues i Suarezit

Barcelona ka filluar kërkimin për zëvendësuesin e Luis Suarezit, i cili është afër t'i mbushë 32 vjet. Sipas medieve në Spanjë, Barcelona e ka etiketuar sulmuesin e Tottenham Hotspurit, Harry Kane, si zëvendësues të Suarezit. Madje drejtuesit e Barcelonës janë gati të ofrojnë 225 milionë euro për anglezin Kane.

#### Sarri: Asnjëherë nuk është lehtë të mposhtet City dhe Guardiola

Trajneri i Chelseat, Maurizio Sarri, është shprehur i kënaqur me fitoren e skuadrës së tij në derbin ndaj Manchester Cityt (2-0). Trajneri italian ka pranuar se asnjëherë nuk është lehtë të mposhtet City dhe trajneri Pep Guardiola. "Jam shumë i gëzuar me fitoren sepse nuk është e lehtë të mundësh Manchester Cityn apo Pep Guardiolen. Jam i kënaqur me mentalitetin e skuadrës. E kemi të vështirë ta gjejmë motivimin por, kur e bëjmë, jemi skuadër shumë e fortë. Luajmë me vendosmëri dhe nivelin e duhur të agresivitetit", ka thënë Sarri. "Lojtarët e mi duhet të vazhdojnë kështu. Patëm disa probleme në 30 minutat e para, sepse Eden Hazardi luajti si sulmues për herë të parë dhe në lëvizjet në mbrojtje nuk ishim të përkryer. Por, e nisëm mirë pjesën e dytë dhe në fund merituar fitoren. Hazardi pati disa probleme vetëm në 20 minutat e fundit të ndeshjes. Ai luajti shumë mirë dhe meritoi të shënonte. Jam i lumtur me këtë ndeshje të tij të parë në këtë pozicion", ka deklaruar Sarri.

#### Di Francesco, afër shkarkimit

Eusebio Di Francesco është afër shkarkimit nga detyra e trajnerit të Romës, pasi dështoi në ndeshjen ndaj Cagliari, edhe përkundër faktit se kishte epërsinë prej dy golave. Kështu në mesjavë verdhekuqtë do të luajnë në transfertë ndaj Viktorias Plzenit, në një sfidë të vlefshme për fazën e grupeve të Ligës së Kampionëve, ku gjithsesi Roma është kualifikuar, ndërsa vëmendja do të jetë te sfida e së dielës përballë Genoa. Nëse shkarkohet Di Francesco, në krye të Romës do të jetë ish-sulmuesi i kësaj skuadre, Vincenzo Montellën.

#### Lowi: Koha ime te Gjermania po përfundon

Joachim Low është trajner i Gjermanisë që nga viti 2006, kombëtare të cilën e dërgoi në majën e botës në vitin 2014. 58-vjeçari ka paralajmëruar se koha e tij si trajner i Gjermanisë është duke përfunduar, kurse mundësinë për ta marrë drejtimin e Real Madridit e ka quajtur si sfidë për çdo trajner. "Ka kaluar pjesa më e madhe e kohës sime si trajner i Gjermanisë. Vjen një moment kur duhet të mendosh se çfarë do të bësh më vonë. Unë vazhdoj të jem i interesuar për të drejtuar një klub dhe mendoj se mund ta bëj një gjë të tillë jashtë Gjermanisë. Real i Madridit? Është një klub interesant për çdo trajner...", ka thënë Low.




**DOLI NË SHITJE  
LIBRI EKSKLUZIV I AUTORIT FATON MEHMETAJ,  
"VEPRIMTARIA E SHËRBIMEVE SEKRETE RUSE  
NË SHTETET E BALLKANIT"**


Libri më i ri i studiuesit dhe njohësit të mirë të çështjeve të sigurisë dhe marrëdhënieve ndërkombëtare, Faton Mehmetaj, "Veprimtaria e shërbimeve sekrete ruse në shtetet e Ballkanit", sjellë të dhëna dhe dëshmi tronditëse mbi shtrirjen dhe

- Si tentuan shërbimet ruse ta destabilizojnë Kosovën?
- Si tentuan grusht shtetin në Mal të Zi, në Shqipëri e Maqedoni?
- Cilat janë shërbimet ruse që operojnë në Ballkan?
- Cilat janë format dhe metodat e shërbimeve sekrete ruse për të destabilizuar rajonin?
- Cila është strategjia e tyre operuese?
- Si ndikuan këto shërbime nëpërmjet medieve, politikës, ekonomisë, të fuqizojnë politikanë dhe struktura politike për t'i pozicionuar në strukturat më të larta të shteteve të rajonit për të mbrojtur interesat pro-ruse?

Përgjigjet në këto pyetje dhe në shumë e shumë pyetje të tjera i gjeni në librin ekskluziv "VEPRIMTARIA E SHËRBIMEVE SEKRETE RUSE NË SHTETET E BALLKANIT", një studim hulumtues, i autorit Faton Mehmetaj, i pari i këtij lloji dhe njëherësh ndër librat më të kërkuar nga lexuesit, ku nxirret lakuriq veprimtaria destabilizuese e shërbimeve ruse në rajon.

Libri përmban 214 faqe dhe është botim i përbashkët i Institutit për Studime Gjeopolitike dhe Siguri (ISGJS) dhe Gazetës së Përditshme Shqiptare "EPOKA E RE", në Prishtinë.





**Lume's Details**  
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

**N.P.T Fruktal-2**  
me datën  
10.12-18.12 fillon  
shitjen e likuidimit  
të mallit 50%.



## Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook 

[www.facebook.com/gjeipuneshpejte](http://www.facebook.com/gjeipuneshpejte)

### >> SHPALLJE TË VOGLA <<

- ▶ Nadmire Bushi shpall te pavlefshme Dëftesat e vitit I,II,III,IV dhe diplomën e Sh.M.L. "Dardania" Hani Elezit.
- ▶ Bashkëpronarja Vesna Grujic shet pjesën e vetë ideale në parcelën kadastrale P-70202018-00001K-0 Zona Kadastrale Gobjule Komuna e Zveçanit. Ftohen bashkëpronaret që nëse janë të interesuar për blerje të kësaj prone të lajmërohen te i autorizuari i saj Savic Dimitrije nga Zveçani.
- ▶ Urgjentisht kërkohet banesë me qira për një çift në Fushe Kosove. Banesa duhet të ketë një dhomë gjumi dhe me kuzhinë të jetë e mobiluar, çmimi: 150-200 euro. Tel 044-741-155
- ▶ Urgjentisht kërkohet banesë me qira në Prishtinë, për një çift me një fëmijë. Banesa duhet të ketë 1 dhomë gjumi dhe me kuzhinë. Po ashtu të jetë e mobiluar si dhe të jetë afatgjatë. Çmimi 200 euro. Tel: 044-741-155
- ▶ Epet lokali me qira në rrugën "B" me sipërfaqe prej 214 m2. Lokali është i përshtatshëm për çfarë do lloj veprimtarie. Informatat në tel: 045-660-118.
- ▶ Shes Truallin në Pejë, për ndërtim lagja Dardania, trualli frekuenton në dy rrugë çmimi sipas marrëveshjes numri kontaktues 044-278-417.
- ▶ Shes Truallin në Pejë, për ndërtim lagja Dardania, trualli frekuenton në dy rrugë çmimi sipas marrëveshjes numri kontaktues 044-278-417.
- ▶ Lëshohet me qira banesën tri dhomëshe në Bregun e Diellit, mbrapa konvikteve të studentëve, kati VI- lifti funksional, e rinovuar komplet me të gjitha elementet, e mobiluar, ka nxehtë qendrore. Banesa lëshohet vetëm për familjar, për banesë duhet të lehet edhe depozitë prej një qeraje. Çmimi 350 euro, tel: 049-400-958
- ▶ Agjencia për patundshmëri "SAZANI", kërkon për blerje dhe lëshojmë me qira: banesa, shtëpi, lokale, troje dhe toka. Ndërmjetësorjme me korrektësi si dhe shesim disa sosh. Numri kontaktues: 044-207-474.
- ▶ Shes shtëpinë në rrugën "Haxhi Zeka" afër Shkollës Teknikë në Prishtinë. Çmimi sipas marrëveshjes. Tel: 049-909-641.
- ▶ Lëshohet banesë me qira në lagjen "Ulpiana" afër AAK-së në Prishtinë. Për informata më të hollësishme lajmërohuni në këtë numër të telefonit: 044-162-783
- ▶ Kimete Lanaj B.I. kërkon një punëkryes për ndërtimin e serrës me sipërfaqe prej 40 ari, me material të zinguar. Oferta zgjat 5 ditë nga dita e shpalljes në gazetë. Kontakti: 044-528-353.
- ▶ Lëshohet banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.
- ▶ Kërkohet kamerier me përvojë pune. Gjendemi në Prishtinë te sheshi "Zahir Pajaziti". Nr: kontaktues- 045-999-985.
- ▶ Lëshohet banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.
- ▶ Lëshohet banesa me qira kati i parë, në rr. Esat Mekuli, çmimi i volitshëm. Për info. 044/ 477-107 Prishtinë. Çmimi shumë i volitshëm dhe është e mobiluar komplet.
- ▶ Lëshohet banesa me qira në qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.
- ▶ Lëshohet banesën e re me qira në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtëra. Informata në tel: 049/44-888-801 (viber)



### OFERTË PËR SHITJE TË SHTËPISË

Shitet shtëpia dykatëshe, me sipërfaqe prej 218 m2, dhe trualli me sipërfaqe prej 410 m2.

Shtëpia gjendet në Prishtinë, në lagjen "Aktash I", rr. "Ferhat Draga" nr. 1.

Procedura e transaksionit nga shitësi te blerësi bëhet pas nënshkrimit të kontratës së shitblerjes dhe pagesës së çmimit të kontraktuar, pastaj paluejtshmëria e përshkruar më lart kalon te blerësi.

Çmimi sipas marrëveshjes.

**Informata më të hollësishme mund të merren në numrin e telefonit 001-347-331-8305 në Nju Jork, kurse në Prishtinë në celularin 044-166-580.**



## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Caseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



## AUTOSHKOLLA "RITMO - L"

**Auto Shkolla  
"RITMO - L"  
Prishtinë**

**Eksperienca jonë  
- përfitimi i juaj.**

**Ju mirëpret:**

**Stafi i Auto Shkollës " Ritmo -L "**

**Tel / kontakt:**

**044 248 173**

**044 200 604**

**044 375 333**